



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Vetëqeverisje Lokale

RAPORT I MONITORIMIT TË KOMUNAVE



Janar-qershor
2011

2011

JANAR-QERSHOR

RAPORT I MONITORIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR VETËQEVERISJE LOKALE

Divizioni i Monitorimit të Komunave

KOMUNAT

Përmbajtja

HYRJE
QËLLIMI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
MBLEDHJET E MBAJTURA
TRANSPARENCA
NUMRI I AKTEVE TË
MIRATUARA
AKTETET MË TË
RËNDËSISHME
PËRMBLEDHJE NGA
MBLEDHJET E MBAJTURA
TË GJETURAT
SHKELJET LIGJORE
KONFLIKTET E INTERESIT
KËSHILLAT KOMUNALE PËR
SIGURI NË BASHKËSI
KONKLuzionET
REKOMANDIMET
AZHURITETI I ADMINISTRATËS
KOMUNALE

Deçan
Dragash
Fushë Kosovë
Ferizaj
Gjakovë
Glllogoc
Graçanicë
Gjilan
Hani i Elezit
Istog
Junik
Kamenicë
Kaçanik
Klinë
Klllokoti
Lipjan
Mitrovicë
Malishevë
Mamushë
Novobërdë
Obiliq
Pejë
Prishtinë
Podujevë
Prizren
Partesh
Rahovec
Ranillug
Skenderaj
Shtime
Shtërpçë
Suharekë
Viti
Vushtrri
Zubin Potokut (nuk ka bashkëpunim)
Zvecanit (nuk ka bashkëpunim)
Leposavicit (nuk ka bashkëpunim)

Hyrje

Në përputhje me detyrimet ligjore dhe misionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale përmes Divizionit të Monitorimit, edhe gjatë periudhës janar-qershor 2011 ka vazhduar punën në drejtim të mbikëqyrjes së funksionimit të Kuvendeve Komunale.

Është obligim i Komunave si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale aktivitetet e tyre t'i ndërmarrin në përputhje me Kushtetutën, parimet që burojnë nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera sektoriale.

Në këtë drejtim, prezantimi i aktiviteteve të kuvendeve të komunave është me rëndësi për informimin e qytetarëve, institucioneve relevante, por edhe vetë komunave, të cilat duke marrë për bazë gjetjet e paraqitura në këtë raport, duhet të ndërmarrin hapa në drejtim të korrigjimit të ngecjeve eventuale.

MAPL, gjegjësisht Divizioni i Monitorimit në kuadër të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale, vazhdimisht monitoron seancat e kuvendeve komunale. Shkeljet e evidentuara në këtë rast, Divizioni i Monitorimit i adreson në Departamentin Ligjor të MAPL-së për procedim të mëtejshëm.

Qëllimi i raportit

Përmes këtij Raporti mundohemi t'u krijojmë informim të duhur qytetarëve lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal.

Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën në lidhje me aktivitetin e pushtetit lokal për periudhën e raportimit.

Në raport janë përfshirë të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të Kuvendeve të Komunave. Po ashtu, përfshihen edhe gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Dokumenti është hartuar në pjesë të ndara, duke përfshirë nga katër ose pesë komuna në grupe, varësisht nga numri i komunave që monitorojnë zyrtarët përgjegjës.

Në kuadër të raportit, përfshihen të dhëna për 34 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë për Komunën e Leposaviqit, Zvecanit dhe Zubin Potokut nuk kemi të dhëna.

PËRMbledhje EKZEKUTIVE

Edhe gjatë vitit 2011, Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal ka përcjellë funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës. Kjo është vazhdimësi e përpjekjeve të Divizionit të Monitorimit me qëllim të ofrimit të informatave mbi nivelin e funksionimit të organeve Komunale.

Raporti në vijim nënvizon se Komunitat qëndrojnë relativisht mirë në kuptimin e përputhshmërisë së veprimeve me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, nuk duhet anashkaluar edhe konstatimin se disa aspekte mbeten për tu përmirësuar nga Komunitat, e sidomos transparenca si element i domosdoshëm për një qeverisje të mirë lokale.

Raporti evidenton çështjet në lidhje me dërgimin e ftesave për mbledhjeve të kuvendeve, numrin e mbledhjeve të Kuvendeve, respektimin e Rregullores së Punës, aktivitetet për hartimin e legjislacionit sekondar, përputhshmërinë e akteve komunale me legjislacionin në fuqi, evidencën e shkeljeve ligjore, punën e Komiteteve të obligueshme, KKS-b-të, efikasitetin dhe azhuritetin e drejtorive komunale, transparençën, e të tjera.

Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës, gjatë periudhës raportuese kanë mbajtur gjithsej 201 mbledhje. Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 dukshëm vërehet shtim i aktiviteteve dhe volumit të punës së tyre, si nga numri i mbledhjeve ashtu edhe nga aspekti i nxjerrjes së akteve komunale.¹



Fig. 1. Krahasimi i mbledhjeve të mbajtura të kuvendeve komunale për gjashtëmuja të parë të vitit 2010 me gjashtëmuja të parë të vitit 2011

¹ Duhet pasur parasysh se në vitin 2010, disa nga komunitat akoma nuk kishin konstituuar organet e tyre pas zgjedhjeve të vitit 2009.

Të gjitha komunat kanë respektuar dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, respektivisht nenin 43.2, për mbajtjen e së paku pesë mbledhjeve të rregullta gjatë gjashtëmujorit të parë vitit.

Të gjitha mbledhjet e Kuvendeve të Komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të rritjes së transparencës komunale, në shumicën e komunave është mundësuar transmetimi direkt apo indirekt i mbledhjeve, nga televizionet lokale.

Gjithashtu, Komunat kanë themeluar komitetet e obligueshme, përveç Komitetit për Komunitete në Komunën e Rahovecit. Lidhur me këtë, me legjislacionin në fuqi komunat obligohen që të jenë transparente edhe me rastin e mbajtjes së punimeve të komiteve të obligueshme. Në këtë drejtim Divizioni i monitorimit ka evidentuar 4 raste kur mbledhjet e Komiteteve obligative nuk kanë qenë të hapura për publikun.²

Derisa komunat kanë përmbushur detyrimin ligjor për numrin e mbledhjeve të Kuvendeve, ajo që mbetet edhe më tutje sfidë ka të bëjë me organizimin e tubimeve publike me qytetarë dhe publikimin e akteve të kuvendit.

Jo të gjitha komunat janë treguar të kujdesshme në thirrjen dhe organizimin e tubimeve publike me qytetarë. Sipas raportit, del që në total janë mbajtur 34 tubime publike me qytetarë. Prej të gjitha komunave, dhjetë komuna nuk kanë mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë.³ Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i komunave aktet e miratuara në kuvend nuk i kanë publikuar në ueb faqet zyrtare. Krahës kësaj, ende nuk është krijuar një sistem unik i publikimit të akteve në ueb faqet zyrtare, madje disa nuk e praktikojnë fare një mundësi të tillë. Kjo krijon vështirësi në informim dhe vë në pikëpyetje transparencën në këtë pikë.

Komunat janë treguar aktive në nxjerrjen e vendimeve në Kuvend. Përqendrim më i madh i këtyre aktiviteteve vërehet në planet rregullative urbane, investime kapitale, partneritetet publiko-private, dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale dhe projektet kapitale. Duhet shtuar që në disa raste, aktet e miratuara në kuvend kanë pasur mangësi në teknikat e hartimit të tyre. Ka edhe nga ato vendime të cilat nuk kanë përmbajtur bazën e duhur ligjore. Ndërsa në disa raste, në pjesën përfundimtare të vendimeve nuk është njoftuar organi mbikëqyrës. Për këtë edhe janë evidentuar 39 raste të shkeljeve ligjore. Në raport kemi paraqitur edhe rastet kur në Kuvende të Komunave janë shfaqur parregullsi procedurale, atëherë kur nuk është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit, bojkotimet e mbledhjeve, ndërhyrjet pavend të drejtorëve në punën e Kuvendit, si dhe çështje të tjera me rëndësi.

Përkundër faktit që janë miratuar shumë rregullore komunale ato nuk janë sjellë tek organet mbikëqyrëse administrative për të konstatuar pajtimin ligjor siç kërkohet me provizionet ligjore. Mbetet akoma sfidë krijimi i një praktike më të mirë nga komunat për t'i mundësuar organit mbikëqyrës rishikimin administrativ. Jo të gjitha komunat zbatojnë detyrimin ligjor për dërgimin e akteve komunale për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Trembëdhjetë komuna nuk i dërgojnë aktet për shqyrtim të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

² Shih Komunat: Mamushë, Dragash, Pejë, Malishevë, Istog, Viti, Podujevë, Shtime, Kaçanik, Graçanicë.

³ Shih Komunat: Mamushë, Dragash, Pejë, Malishevë, Istog, Viti, Podujevë, Shtime, Kaçanik, Graçanicë.

Krahasuar me vitin 2010, gjatë vitit 2011 vërehet një ngritje e nivelit të bashkëpunimit në mes të komunave dhe MAPL-së. Përderisa në vitin paraprak një numër i konsiderueshëm i komunave nuk kanë dërguar me kohë ftesën dhe materialet e mbledhjeve të Kuvendeve, tanimë pothuajse të gjitha komunat përmbushin këtë obligim ligjor.

Me qëllim të bashkëpunimit më të ngushtë me komunat, në këtë gjashtëmuajor MAPL ka realizuar takime të rregullta me drejtorë të administratës së komunave.⁴

Një sferë tjetër që prek bashkëpunimin në mes të dy niveleve është edhe konsultimi paraprak. Në kuadër të kësaj, duhet vlerësuar kërkesat e komunave për konsultim paraprak para nxjerrjes së vendimeve në kuvende të komunave.

Megjithëse komunat kanë themeluar Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB), raporti flet që shumica e komunave nuk kanë përmbushur numrin e nevojshëm të takimeve të këtij Këshilli. Duhet shtuar që KKSB është trup konsultues për çështje të sigurisë me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive në komunë dhe që ka për qëllim vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me respektimin e rendit publik, sigurisë, si dhe të evidentojë e të luftojë parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet.

Sipas të dhënave, shtatë komuna ende nuk kanë mbajtur asnjë takim të KKSB-së për këtë periudhë, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme janë treguar mjaft pasive në thirrjen e mbledhjeve të Këshillit.⁵

Ndërkaq, komunat të cilat kanë mbajtur mbledhje të KKSB-ve konform rregullave ligjore që përcaktojnë numrin e mbledhjeve janë: Komuna e Malishevës, Kllkotit, Vushtrrisë, Istogut, Skenderajt dhe Mitrovicës.

Një pjesë e raportit i është kushtuar edhe konfliktit të interesit dhe mbajtjes së pozitave të dyfishta. Raporti tregon që në komuna nuk ka ndodhur asnjëherë që kryesuesi i kuvendit t'i pyet kuvendarët për konfliktin e interesit, para shqyrtimit ose votimit të ndonjë pike të paraparë në rendin e ditës. Për këtë arsye edhe është bërë e pamundur identifikimi i rasteve të konfliktit të interesit. Po ashtu, rrallëherë ndodhë që ndonjë nga kuvendarët të tërhiqen nga procesi i votimit në rastet kur mund të shfaqet konflikti i interesit. Përveç kësaj, në raport janë paraqitur edhe rastet e mbajtjes së pozitave të dyfishta.

⁴ Në bazë të një marrëveshjeje me Kryetarë të Komunave, drejtorët e administratës së komunave janë caktuar pikë kontaktuese me MAPL-në.

⁵ Shih Komunat: Junik, Novobërdë, Ranillug, Graçanicë, Dragash, Partesh, Mamushë, Shtërpcë, Viti, Obiliq.

KOMUNAT: GJAKOVË, DEÇAN, RAHOVEC, JUNIK




Fig. 2. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Mbledhjet e mbajtura


Gjashtëmujori i parë i vitit 2011 në Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Rahovec, Deçan dhe Junik ka ecur me ritëm të mirë të mbajtjes së mbledhjeve. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur mbledhjeve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe tubimeve publike me qytetarë. Nga aspekti kuantitativ të katër komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e mbledhjeve. Në Kuvendet e këtyre komunave

janë thirrur gjithsej 24 mbledhje, prej të cilave një ka dështuar (Rahovec).

Pasqyra e mbajtjes së mbledhjeve tregon se të katër komunat qëndrojnë në përputhje me normat ligjore që kërkojnë për mbajtjen e numrit të caktuar të mbledhjeve.

Për të paraqitur vëllimin e mbajtjes së mbledhjeve në mënyrë më të qartë duke krahasuar me vitin 2010, më poshtë kemi paraqitur të dhënat në formë tabelore.

Fig. 3. Krahasimi i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011



Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2010, gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2011 Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka treguar rënie në numrin e mbledhjeve të mbajtura, Komuna e Gjakovës dhe Junikut treguan ritëm të njëjtë në mbajtjen e mbledhjeve, kurse Komuna e Deçanit ka shënuar ngritje.




Fig. 4. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të Obligueshme në Komunat: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Në këto komuna kanë qenë funksionale edhe Komitetet e obligueshme, duke përjashtuar Komitetin për Komunitete në Komunën e Rahovecit që nuk është mbledhur asnjë herë. Numri i mbledhjeve të komiteteve qëndron si në grafikun 4:

Të dhënat mbi pasqyrën e mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme tregojnë se Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Deçanit dhe Gjakovës ka mbajtur nga 7 mbledhje, në Komunën e Junikut ka mbajtur 5 mbledhje dhe në Komunën e Rahovecit 4 mbledhje. Krahas kësaj, Komiteti për Komunitete në Deçan është mbledhur 6 herë, Gjakovë 4, Junik 5, ndërkohë që në Rahovec nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Sa i përket aktivitetit normativ, komunat kanë miratuar një numër të konsiderueshëm të akteve në kuvendet e tyre. Sipas të dhënave, rezulton se Kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar gjithsej 55 vendime dhe 13 rregullore. Pasqyra e të dhënave mbi aktet e miratuara në Kuvendet e Komunave Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec tregon se më aktive në nxjerrjen e vendimeve ka qenë Kuvendi i Komunës së Gjakovës me 19 vendime dhe 2 rregullore, në vijim është Komuna e Deçanit me 18 vendime dhe 2 rregullore, Komuna e Junikut me 14 vendime dhe 3 rregullore, ndërkohë që Komuna e Rahovecit ka miratuar vetëm 5 vendime dhe 1 rregullore.




Fig. 5. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Me qëllim të krijimit të kushteve për sjelljes së qytetarëve sa më afër procesit vendimmarrës, komunat kanë mbajtur takime publike me qytetarë. Tubimet publike me qytetarë janë realizuar si vijon: Komuna e Junikut Gjakovës dhe Deçanit kanë mbajtur nga 1 tubim publik me qytetarë, ndërsa Komuna e Rahovecit 2.

Edhe pse këto komuna kanë të miratuar Rregulloren për Transparencë, çështja publikimit të akteve komunale nuk aplikohet në praktikë.⁶

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave përgjithësisht ka rrjedhur mirë, por nuk duhet përjashtuar disa aspekte juridike që duhet trajtuar. Duke filluar nga momenti kur dërgohet thirrja (njoftimi) për mbledhjeve, ende ka disa komuna të cilat nuk dërgojnë gjithë materialin e mbledhjes të kompletuar. Është Komuna e Deçanit ajo e cila në asnjë rast ftesës së mbledhjes nuk i ka bashkangjitur të gjithë materialin e mbledhjeve, ndërkohë që Komuna e Rahovecit nuk ka dërguar ftesën me rastin e mbajtjes së mbledhjes kur është dhënë betimi i kryetarit të Komunës.

Megjithëse ka një përmirësim solid të komunikimit me komunat, ende mbetet vështirësi sigurimi i informatave nga zyrtarët komunal. Për Divizionin e Monitorimit të MAPL-së, shpeshherë ka qenë e vështirë marrja me kohë e informatave nga zyrtarët komunal (përjashtim bën zyrtari kontaktues në Komunën e Gjakovës). Mos përdorimi i rregullt i adresave elektronike zyrtare si dhe hezitimi i zyrtarëve komunal për të ofruar përgjigje në raste të caktuara, shpeshherë ka vështirësuar komunikimin zyrtar.

Përveç kësaj, duhet shtuar se jo të gjithë drejtorët e administratës së këtyre komunave kanë respektuar Vendimin e kryetarit të tyre, me të cilin obligohen që të jenë pikë kontaktuese me MAPL-në. Drejtorët e administratës së katër komunave, jo gjithëherë kanë marrë pjesë në takimet e rregullta të organizuara në mes tyre dhe MAPL-së.⁷ Këto takime konsiderohen të jenë mjaft të rëndësishme dhe organizohen me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve në mes të nivelit lokal dhe atij qendror.

Me nenin 80 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat obligohen të dërgojnë aktet e tyre për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë. Me përjashtim të Komunës së Gjakovës, tri komunat tjera (Rahoveci, Juniku dhe Deçani) nuk kanë dërguar asnjë nga aktet e miratuara të kuvendit të komunës për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës (MAPL). Ajo që mbetet për tu realizuar më tutje nga këto komuna, është krijimi i një sistemi të mirëfilltë të bashkëpunimit, përmes së cilit do të sigurohej ligjshmëria e aktiviteteve të organeve komunale. Në këtë kontekst, Komuna e Junikut, Deçanit dhe Rahovecit duhet të fillojnë me dërgimin e

⁶ Me Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/03 për ndryshimin e U.A. 2006/03 "Për Transparencën në Komuna", në parag. 1 të nenit 4 theksohet se "Të gjitha vendimet, rregulloret dhe aktet tjera të Kuvendit të Komunës publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumentet zyrtare bëhen publike një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet. Njëra ndër mundësitë për publikim me këtë Udhëzim është paraparë edhe Ueb faqja zyrtare e komunës.

⁷ Deçani dhe Juniku, janë komunat të cilat drejtorët e administratës së tyre nuk kanë marrë asnjëherë pjesë në takimet e rregullta me MAPL-në.

akteve të tyre për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës.

Krahas kësaj, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, çdo anëtar i Kuvendit duhet ti shfaqë të gjitha konfliktet e interesit të cilat mund të lindin në kuadër të mbledhjeve ku ata janë prezent. E drejtë e anëtarëve të kuvendit është edhe ofrimi i informacioneve për interesat e anëtarëve të tjerë. Sipas të raporteve të monitorimit, deri tani nga anëtarët e kuvendit nuk është deklaruar nëse ka pasur konflikt interesi për ndonjë nga çështjet e votuara në kuvend. Në asnjë rast kryesuesit e kuvendeve të këtyre komunave nuk kanë parashtruar pyetjen nëse ka konflikt interesi para diskutimit ose votimit të një pike të rendit të ditës. Kjo ka pamundësuar identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, ngase anëtarët e kuvendit nuk deklarojnë një gjë të tillë. Përveç kësaj, nuk është shënuar asnjë rast që anëtarët e kuvendit të japin informacione për interesat e anëtarëve të tjerë. Sa i përket pozitave të dyfishta, gjatë kësaj periudhe nuk është identifikuar ndonjë rast i tillë.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – gjatë periudhës janar-qershor 2011, KKSB ka mbajtur mbledhjet si në vijim:




Fig. 6. Numri i mbledhjeve të KKSB-ve në Komunat: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Rahovec

Nga grafiku i mësipërm shohim se asnjëra nga Komunat nuk ka përmbushur numrin e kërkuar të mbledhjeve të KKSB-së ashtu siç kërkohet me U.A. nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL, me të cilin përcaktohet që KKSB mbledhet jo më pak se dhjetë herë në vit. Edhe pse me Udhëzimin Administrativ në fjalë nuk parashihet periudha e mbajtjes së këtyre mbledhjeve, mirëpo ceket që ato të mbahen gjatë vitit, trendi i mbajtjes së mbledhjeve nuk tregon interesimin e Komunave në funksionalizimin e plotë të KKSB-së. Për më tepër, Komuna e Junikut nuk është treguar fare aktive në mbajtjen e takimeve të KKSB-së.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

GJAKOVË

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, gjatë periudhës janar-qershor 2011 është mbledhur gjithsej 6 herë. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete të shumta, ku janë trajtuar çështje me interes për qytetarët e kësaj komune.

Në shkurt të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka zgjedhur kryesuesin e ri të Kuvendit. Pas zgjedhjeve qendrore të mbajtura në dhjetor të vitit 2010, ish-kryesuesja e Kuvendit të Komunës ka ofruar dorëheqjen nga pozita e saj, për të vazhduar si deputete në Parlamentin e Kosovës.

Komuna e Gjakovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar planifikimit urban si dhe mbrojtjes së mjedisit. Në seancën e 27 janarit të vitit 2011, është nxjerrë Vendimi për shpalljen e lokacionit "Shkugësa"- zonë me interes të përgjithshëm. Krahas kësaj, është miratuar edhe kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit për aprovimin e Strategjisë për adaptimin, ristrukturimin ose implementimin e Planit Rregullues Urban "Rezina". Gjithashtu, me rëndësi është edhe vendimi që Komuna e Gjakovës të jetë pjesë e Agjensionit të Zhvillimit Rajonal me seli në Pejë, vendim i miratuar më 24 shkurt 2011. Ndërsa, në seancën e marsit është miratuar Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve në territorin e Komunës së Gjakovës. Po ashtu, vlen për tu përmendur edhe vendimi mbi shqiptimin e masave disiplinore për gjashtë nxënës të Shkollës së Mesme "Kadri Kusari" në Gjakovë.

Në mbledhjen e muajit prill është miratuar raporti i buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2010 si dhe Plani rregullues urban zona "Jugu 2".

Në muajin maj është bërë ndryshimi i Rregullores Komunale mbi caktimin e orarit të punës së barnatoreve që veprojnë në Komunën e Gjakovës. Me këtë vendim, është zgjatur orari i punës së barnatoreve që veprojnë në këtë komunë. Gjithashtu, në këtë mbledhje është bërë këmbimi i pronës në mes të KBI Ereniku dhe Komunës së Gjakovës për nevojat e rrugës gjerë në ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe që lidhet me projektin e ndërtimit të kanalizimit në fshatin Skivjan, donacion i fituar nga Komisioni Evropian në vlerë prej 700.000 euro.

Në këtë mbledhje po ashtu është revokuar vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës për shpalljen e lokacionit "Shkugësa" zonë me interes të përgjithshëm. Me këtë rast, Kuvendi i Komunës nxjerr Vendim tjetër për këtë zonë, duke ndryshuar bazën ligjore të vendimit dhe duke u thirrur në nenin 21. pika 1 dhe 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës nr.03/L-233. Me këtë Vendim lokacioni "Shkugësa" vihet në mbrojtje në kategorinë – Peisazh i mbrojtur. Për këtë vendim Komuna e Gjakovës ka marrë pëlqimin paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ashtu siç kërkohet me nenin 19.3 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës nr.03/L-233.

Nga punimet e mbledhjes së Kuvendit të Komunës të mbajtur më 30 qershor u nxorën disa vendime. Në këtë mbledhje është miratuar kërkesa për legalizimin e gjendjes ekzistuese në sipërfaqen "Rrezina Veriore", fazë e parë e propozuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Gjithashtu është miratuar Vendimi mbi miratimin e Rregullores për Shërbimin e Transportit me "Merimangë", e propozuar nga Drejtoria për Shërbime Publike. Po ashtu, është ndryshuar përbërja e Komitetit për Komunitete, si dhe është miratuar kërkesa për dhënien në shfrytëzim të parcelës 5 ari për nevojat e biznesit për menaxhimin e mbeturinave në lagjen "Ali Ibra".

Të gjeturat

Edhe gjatë periudhës janar-qershor 2011, Kuvendi i Komunës së Gjakovës nuk ka kaluar pa shkelje ligjore.

- Ajo çka është vërejtur në mbledhjen 24 shkurtit të vitit 2011 të Kuvendit të Komunës, është mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që rregullojnë procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit. Më konkretisht, është bërë anashkalimi i paragrafit 3 të nenit 41 të LVL-së, sipas të cilit "Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta". Neni në fjalë nuk është respektuar ngase, procedura e votimit nuk është bërë me vota të fshehta por me votim të hapur.
- Mosrespektim i rregullave ligjore që kërkohen me rastin e nxjerrjes së vendimeve përbënë edhe nxjerrja e Vendimit për shpalljen e lokacionit "Shkugëza" zonë me interes të përgjithshëm në dobi të Komunës së Gjakovës. Vendimi në fjalë nuk ka përmbajtur bazën e duhur ligjore, për arsye se është thirrur në nenin 3. al. 2 të Ligji mbi eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e KSAK 21/78), ligj ky i cili është shfuqizuar me Ligjin mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139. Ky vendim është anuluar me datën 30.05 2011 nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe është nxjerrur Vendimi për vënien e lokacionit "Shkugëza" në kategorinë "Peisazh i mbrojtur".
- Vendimi mbi dhënien në shfrytëzim të parcelës 5 ari për nevojat e biznesit për menaxhimin e mbeturinave në lagjen "Ali Ibra", edhe pse është thirrur në nenin 5 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 03/L-226, në dispozitiv të vendimit nuk specifikohet periudha e dhënies në shfrytëzim të kësaj prone. Në këtë pjesë të vendimit figuron se "Prona komunale jepet në shfrytëzim në kohëzgjatje sipas marrëveshjes së projektit". Duke i'u referuar kësaj, neni 5 i Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, lejon dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në një afat prej 10 viteve ose deri në 40 vite me pëlqimin e ministrive përkatëse. Prandaj Komuna e Gjakovës do duhej të përcaktonte kohën e dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele. Vendimi në fjalë është dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në Departamentin Ligjor i MAPL-së.
- Komuna e Gjakovës ka të rezervuar pozitën e zëvendëskryesuesit të kuvendit të Komunës për Komunitete, ndërkohë që ka vetëm 6% të komuniteteve pakicë. Në nenin 54.1 të LVL-së parashihet që "Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë,

postit i zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve". Prandaj, në bazë të kësaj, vërejmë që Ligji parasheh përqindje më të lartë të qytetarëve pakicë për t'u rezervuar një pozitë e tillë.

RAHOVEC

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë periudhës janar-qershor 2010 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Megjithatë ky Kuvend është thirrur 6 herë, njëra nga mbledhjet ka dështuar.

Në janar të vitit 2011 është thirrur mbledhja solemne, me ç'rast kryetari i Komunës z. Smajl Latifi ka dhënë betimin para anëtarëve të kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit nuk ka treguar edhe aq rezultat në nxjerrjen e vendimeve. Kështu, janë miratuar vetëm 5 vendime. Një ndër vendimet e miratuara është Vendimi për orarin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2011. Po ashtu, është miratuar edhe Vendimi mbi mbështetjen e propozimit të Drejtorisë së Arsimit për shqiptimin e masave disiplinore ndaj 28 nxënësve të shkollës së mesme "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec dhe 6 nxënësve të shkollës së mesme "12 Maji" në Ratkoc.

Në mbledhjen e 15 marsit 2011 janë diskutuar çështje me rëndësi për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Në rend dite ishin paraparë për diskutim dhjetë pika, ndërsa anëtarët e kuvendit vendosën në heqjen e tri pikave. Ndër pikat më të diskutueshme zuri vend Shqyrtimi i raportit të auditorit të brendshëm për vitin 2009. Për këtë pikë janë ngrehur shqetësime për keqpërdorime të shumta e sidomos shkelje të pretenduara të Ligjit për Prokurim, madje duke shtruar edhe nevojën e zgjerimit të hetimeve.

Në mbledhjen e muajit prill është bërë shqyrtimi i raportit të Auditorit të brendshëm për Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Shërbimit Pronësor-Juridik për vitin 2010. Gjithashtu është shqyrtuar edhe Raporti mbi punën e Avokatit Publik të Komunës së Rahovecit për vitin 2010.

Në mbledhjen e prillit është miratuar Vendimi mbi dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr 3213 zona kadastrale Rahovec pronë e Komunës së Rahovecit. Me këtë vendim prona në fjalë i është dhënë në shfrytëzim Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec me qëllim të ndërtimit të Qendrës Kulturore për qëllime humanitare.

Në muajin maj është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës me të vetmen pikë të rendit të ditës, Peticioni i banorëve të fshatit Fortesë lidhur me ndërtimin e fabrikës për ndërtimin e tjegullave, investim ky i kompanisë turke Li-Kos Toprak. Ky peticion i është drejtuar Kuvendit të Komunës së Rahovecit, përmbajtja e të cilit shpreh mospajtimin e 800 banorëve të këtij fshati për ndërtimin e Fabrikës së tjegullave. Lidhur me këtë çështje në muajin prill është mbajtur edhe një debat publik me qytetarë, mirëpo qytetarët kishin shprehur mospajtimin e tyre për dertimin e fabrikës. Ndërtimi i kësaj fabrike rrjedh nga një Vendim i mëparshëm i miratuar në korrik të vitit 2010 nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, me të cilin kompanisë Li-Kos Toprak i jepet prona në shfrytëzim për ndërtimin e fabrikës së tjegullave. Me gjithë shqetësimin e shprehur nga qytetarët për ndërtimin e kësaj fabrike, disponim i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit ishte që të

mos anulohet vendimi i Kuvendit, për shkak të rëndësisë ekonomike të projektit. I njëjti projekt është mbështetur edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Agjencioni për Promovim e Investime në Kosovë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), të cilët kanë vlerësuar se ndikimi në mjedis me rastin e ndërtimit të fabrikës është në masën e tolerueshme sipas parametrave ndërkombëtarë mjedisor. MMPH gjithashtu është zotuar se në rast se vihet deri te konstatimet se investitori nuk i përmbush kushtet e parapara mjedisore dhe nëse nuk respektohen kushtet e kontratës, atëherë mund të tërhiqet leja dhe të merren masa ndaj investitorit.

Me qëllim të forcimit të rëndësisë së këtij projekti dhe shkëmbimit të përvojave me vende të tjera, kryetari i Komunës së Rahovecit është zotuar se me një grup të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe banorëve të fshatit Fortesë do të realizojnë një vizitë studimore në Turqi në mënyrë që të shihet se si janë realizuar këto projekte atje dhe në çfarë mase është mbrojtur ambienti e prona private. Qëndrim i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit ishte që pas realizimit të vizitës, të shkohet me referendum nga banorët e fshatit Fortesë.

Ligji për Vetëqeverisje lokale nuk ka paraparë shprehimisht të drejtën e qytetarëve për të kërkuar referendum, përveç kërkesës që një rregullore e miratuar në Kuvend t'i nënshtrohet referendumit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që banorët e fshatit Fortesë të mos kenë të drejtën për tu deklaruar për çështje të rëndësishme dhe që vendimi i tyre i shprehur përmes referendumit të jetë i obligueshëm dhe i zbatueshëm. Koncepti i vetëqeverisjes lokale në Kosovës është i ndërtuar mbi bazën e parimeve që dalin nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, zbatimi i të cilave është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale qytetarëve i'u njeh të drejtën e referendumit si formë e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes.

Në vazhden e aktiviteteve të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2011, është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Me këtë rregullore Kuvendi i komunës ka paraparë ulje të tarifave për kategoritë e caktuara të shërbimeve. Gjithashtu, në këtë mbledhje është shqyrtuar kërkesa e KRM "Eko-regjioni" në Prizren përkatësisht njësisë në Rahovec. Për shkak të shkallës së ulët të inkasimit të mjeteve nga kjo kompani, që ka rrjedhur si rezultat i mospagesës së obligimeve nga qytetarët dhe bizneset, kompania "Eko-regjioni" është vlerësuar të jetë në gjendje të rëndë financiare duke mos pasur mundësi edhe në kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të saj. Me këtë rast, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka nxjerrë një Vendim me të kufizon qytetarët, bizneset dhe institucionet tjera në pranimin e shërbimeve nga komuna nëse nuk kryejnë obligimet ndaj kompanisë në fjalë. Më konkretisht Vendimi parasheh që qytetarët, bizneset dhe institucionet e Komunës së Rahovecit, të cilat shfrytëzojnë shërbimet komunale në grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të ofruara nga KRM "Ekoregjioni" – Njësia në Rahovec, kushtëzohen të dëshmojnë me vërtetim shlyerjen e borxheve ndaj kësaj kompanie, me rastin e nxjerrjes së dokumentacioneve, si vijon: Vërtetimin mbi taksat komunale për regjistrimin e automjeteve, dokumentacionin kadastral, lejet

ndërtimore dhe vazhdimin e lejeve të punës për biznes.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka shfrytëzuar mundësinë e konsultimit paraprak me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal. Kuvendi ka dërguar kërkesë për ndihmë juridike në lidhje me veprimet të cilat duhet t'i ndërmarr për mbrojtjen e shtratit të lumit "Drini i Bardhë".

Të gjeturat

Në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, si vitin e kaluar, ashtu edhe në këtë vit, janë shënuar raste të shpeshta të bojkotimit të seancave nga anëtarët e Kuvendit. Një gjë e tillë është paraqitur edhe në muajin mars të këtij viti.

- Më datën 23.03.2011, mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Rahovecit ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit, si pasojë e lëshimit të mbledhjes nga anëtarët e subjektit politik të PDK-së dhe AAK-së, të cilët nuk miratuan rendin e ditës për shkak të mospajtit me të dy propozim-vendimeve për "Caktimin e zonave të interesit të veçantë". Këto dy propozime, nuk kishin arritur të kalojnë edhe në një seancë të mbajtur më datë 15 mars 2011.
- Komiteti për Komunitete në Komunën e Rahovecit që nga themelimi nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, për shkak mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të komunitetit serb.
- Komuna e Rahovecit hyn në grupin e komunave të cilat nuk dërgojnë aktet e Kuvendit për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë.
- Me rastin e nxjerrjes së Vendimit për dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr. 3413. z.k. Rahovec Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec me qëllim të ndërtimit të Qendrës Kulturore për qëllime humanitare, nuk është saktësuar periudha e dhënies në shfrytëzim të kësaj toke. Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.03/L-226, në nenin 10 i jep të drejtën Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim deri në 10 vjet pronën e paluajtshme komunale në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik dhe deri në 40 vjet pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me Ligjin e prokurimit dhe dhënies së pëlqimit nga MEF-i, MMPH dhe MTI.
- Një çështje tjetër që kërkon trajtim është rrjedha e punës së mbledhjes në Kuvend. Në shumë raste nuk respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, me rastin e marrjes së fjalës dhe dhënies së deklarimeve. Fjalimet për më tepër shërbejnë për promovime personale se sa profesionale, duke bërë që Kuvendi i Komunës të mos jetë shumë produktiv në punën e tij.

DEÇAN

Kuvendi i Komunës së Deçanit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2011 ka realizuar 5 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Kuvendi i Komunës është shprehur shumë konstruktiv në lidhje me interesat e qytetarëve, me ç'rast edhe roli i opozitës është për t'u vlerësuar. Gjatë periudhës në fjalë Kuvendi i Komunës së Deçanit ka miratuar gjithsej 16 vendime dhe 2 rregullore.

Në mesin e shumë akteve të miratuara vlen për tu përmendur miratimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga uji, miratimi i Rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Vendimi për dhënien e dekoratës "Shkëlzen Haradinaj" dhe Vendimi për formimin e komisionit për ndryshimin dhe harmonizimin e logos së Komunës së Deçanit.

Komuna e Deçanit iu ka përgjigjur pozitivisht shkresës së MAPL-së e cila i'u është dërguar të gjitha komunave për harmonizimin e logove në përputhje me legjislacionin në fuqi. Meqenëse në logon e Komunës së Deçanit emri i komunës ka figuruar vetëm në gjuhën shqipe, në seancën e marsit të vitit 2011 është formuar komisioni në përbërje prej 9 anëtarëve i cili do të bëjë përzgjedhjen e logos sipas kriterëve të kërkuara me legjislacion. Gjithashtu, në një mbledhje solemne të mbajtur në mars, z. Sverre Johan Kvale, ambasador i Norvegjisë në Republikën e Kosovës, shpallet qytetar nderi i Komunës së Deçanit.

Në mbledhjen e muajit prill Kuvendi i Komunës ka nxjerrë Vendimin mbi formimin e këshillit profesional për planifikim hapësinor të Komunës së Deçanit, në përbërjen e të cilit është paraparë të jenë 7 anëtarë, me detyrën e dhënies së mendimeve, propozimeve dhe vërejtjeve në dokumentet e planifikimit hapësinor si: Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban, Planeve Rregulluese urbane dhe atyre të zonave të veçanta. Po ashtu, është janë miratuar edhe këto vendime: Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut regional të kafshëve, Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për emërimin e shesheve dhe rrugëve në fshatrat dhe në qytetin e Deçanit. Në mbledhjen e mbajtur në maj, është miratuar Planit Rregullues Urban "Qesta" së bashku me Planin rregullues për hapësirën e varrezave të Komunës së Deçanit. Në këtë mbledhje është miratuar edhe Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje, ndërsa në mbledhjen e mbajtur me 30.06.2011 është miratuar Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Planit Rregullues "Qendra".

Të gjeturat

- Në komunën e Deçanit ende vazhdon funksionimi i dy drejtorive në kundërshtim me Statutin e Komunës.
- Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2011, janë shënuar dy raste të bojkotimit të mbledhjeve të Kuvendit nga partitë opozitare. Në mbledhjen e muajit maj dhe qershor 2011, subjektet politike opozitare, pas aprovimit të rendit të ditës kanë lëshuar mbledhjen në shenjë proteste ndaj ekzekutivit për mos dhënien e raporteve të qarta mbi të gjitha shpenzimet e bëra nga ko-

muna, me pretendimin e opozitës së ka pasur keqpërdorime. Kërkesë e tyre ishte që në kuadër të trajtimit të raportit financiar për periudhën e vitit paraparak dhe për vitin 2011, të ofrohen të gjitha informatat mbi shpenzimet e bëra nga ekzekutivi, kontratat e lidhura në mes të komunës dhe bizneseve private të cilat shfrytëzojnë lokalet e komunës, implementimin e tyre, si dhe çdo formë e pagesës që lidhet direkt me këto kontrata. Në mungesë të ofrimit të këtyre të dhënave nga ekzekutivi, për dy mbledhje radhazi anëtarët e kuvendit nga subjektet politike të opozitës lëshuan mbledhjen. Neni 58 i LVL-së, përcakton që kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Duke u bazuar në këtë nen, kryetari i komunës është i obliguar të ofroj raporte financiare sa herë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Andaj, Divizioni i Monitorimit konstaton dhe rekomandon që kryetari i Komunës së Deçanit duhet të ofroj informata shitesë lidhur me pasqyrën e shpenzimeve të Komunës si dhe implementimin e çdo kontrate të lidhur nga ana e komunës.

- Komuna e Deçanit nuk dërgon aktet e miratuara në Kuvend për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë.

JUNIK

Gjatë periudhës janar-qershor 2011, Kuvendi i Komunës së Junikut ka thirrur gjithsej 6 mbledhje. Kuvendi, gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 14 vendime dhe 3 Rregullore. Ndër vendimet më të rëndësishme është Vendimi mbi miratimin e Rregullores për Pastërtinë e Qytetit, me të cilin rregullohet çështja e mbajtjes së higjienës dhe pastërtisë së hapësirave publike, por edhe sipërfaqeve tjera. Vendim tjetër është ai për lejimin e 7 nxënësve të gjimnazit "Kuvendi i Junikut për të vijuar mësimin rregullisht, pasi që ishte propozim i Drejtorisë së Arsimit që këta nxënës të suspendohen nga procesi i rregullt i mësimi. Kështu, Kuvendi i Komunës së Junikut ka vepruar ndryshe, duke iu dhënë edhe një mundësi këtyre nxënësve për të vijuar mësimin normalisht. Për këtë çështje, komuna e Junikut përkatësisht kryetari i komunës ka kërkuar shqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi në Departamentin Ligjor të MAPL-së. I njëjti vendim i është përcjellë Ministrisë së Arsimit për vlerësim të ligjshmërisë.

Në mbledhjen e muajit prill është miratuar Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban njësia "Krasniq" dhe "Bajraktar" dhe Vendimi për themelimin e këshillit të ekspertëve për planifikim. Ndërsa, disa nga vendimet e muajit maj janë: Vendimi për ndryshimin e Statutit të QKMF-së në Junik, Vendimi mbi vënien në diskutim publik të Rregullores për llogaritjen dhe pagesën e kompensimit për rregullimin të tokës ndërtimore, Vendimi për emërtimit e Bibliotekës Komunale në Junik dhe Vendimi mbi kompensimin e ngastrës kadastrale me nr. 3262, pronë private.

Gjatë zhvillimeve të punimeve në Kuvend në muajin maj, ajo që ngjalli më tepër diskutim është

çështja e përfaqësimit të subjekteve politike në Komitetin për Politikë dhe Financa. Meqenëse njëri anëtarë i kuvendit ka kaluar nga LDD në AAK e cila ka shumicën e ulëseve në Kuvend, mbeti e paqartë përfaqësimi i subjektit politik të LDD-së në KPF. Në bazë të nenit 52 të LVL-së, Statutit të Komunës së Junikut dhe Vendimit 001/06 datë 22.02.2010 të Kuvendit të komunës së Junikut, Divizioni i Monitorimit të MAPL-së rekomandon Komunën e Junikut që duhet të bëhet zëvendësimi anëtarit të KPF-së, në mënyrë që ky Komitet të reflektoj përfaqësimin e të gjitha entiteteve politike të Kuvendit të Komunës.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin qershor, Kuvendi i Komunës së Junikut ka shqyrtuar raportin e shpenzimeve për periudhën janar-mars 2011. Ky raport ka reflektuar ndryshimet dhe rritjen e shpenzimeve të buxhetit të komunës, pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e pagave në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimit civil. Raporti u diskutua pa ndonjë vërejtje thelbësore nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në këtë mbledhje është marrë vendimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2012. Gjithashtu, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar dhe miratuar Rregulloren për mbrojtje nga zjarri, e cila është përpiluar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektorat dhe Emergjencë. Me këtë rregullore Komuna e Junikut ka vënë për objektiv përforcimin e shërbimit të zjarrfikësve. Duhet shtuar se në mbështetje të shërbimit të zjarrfikësve, Komunës së Junikut i ka ndihmuar edhe Komuna e Istogut me dhurimin e një kamioni të zjarrfikësve. Pas vendimit në fjalë, kjo Rregullore para finalizimit, do të kalojë për diskutim në debat publik me qytetarë. Vendim tjetër i mbledhjes së muajit qershor është ai për themelimin e një Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Junikut. Kuvendi i Komunës së Junikut ka miratuar Vendimin për procedurat e konfiskimit të masës drunore nga prerësit ilegal të drunjve.

Të gjeturat

- Të gjeturat e raportit tregojnë se gjatë seancave nuk janë respektuar rregullat e debatit të përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Për më tepër, janë vërejtur ndërhyrjet e shpeshta të drejtorëve të komunës në punën e Kuvendit edhe atëherë kur nuk kërkohej sqarim.
- Rast me rëndësi për tu përmendur është ndërhyrja e Drejtorit të Arsimit lidhur me pikën e rendit të ditës për "Shqiptimin e masave të ndëshkimit për 7 nxënës të Gjimnazit "Kuvendi i Junikut", me ç'rast e njëjta çështje është kthyer për rivotim.
- Krahës kësaj, është vërejtur edhe mungesa e prezencës së zyrtarit ligjor në punën e Kuvendi të Komunës, e që realisht në disa raste është shprehur nevoja për dhënien e sqarimeve ligjore.
- Sa u përket vendimeve, konsiderojmë se Vendimi i Kuvendit të Komunës lidhur me lejimin e vazhdimin të mësimin të rregullt për 7 nxënës të Gjimnazit "Kuvendi i Junikut", nuk është në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe Udhëzimin Administrativ nr. 6/2010 për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta. Udhëzimi Administrativ nr. 6/2010 për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës

të shkollave të mesme të larta, parasheh obligimet e nxënësve në procesin mësimor si dhe masat të cilat mund të shqiptohen ndaj nxënësve të cilët kryejnë veprime të ndaluara. Në paragrafin 1.4 të nenit nën 7 të U.A, masën nga paragrafi 6.3.1.3 (Pezullimin më shumë se një muaj) e shqipton Kuvendi i Komunës, duke siguruar arsimin alternativ për nxënësit e pezulluar. Duke marrë parasysh natyrën dhe peshën e veprës së kryer nga këta nxënës, Kuvendi i Komunës së Junikut me këtë rast nuk ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo ngase nuk është shqiptuar asnjë masë edukative – disiplinore ndaj këtyre nxënësve, e që do të ndikonte në riedukimin, zhvillimin e përgjegjësive personale dhe parandalimin e sjelljeve të ngjashme. Lidhur me këtë vendim, më tepër është vërejtur mungesë e njohurive të anëtarëve të Kuvendit lidhur me masat të cilat mund të shqiptohen për raste të tilla.

- Komiteti për Politikë dhe financa, në përbërjen e tij nuk reflekton përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike të Kuvendit të Komunës.
- Komuna e Junikut nuk i dërgon aktet e miratuara në Kuvend për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë.

● Konkluzione

1 Komunitetet përgjithësisht kanë dërguar me kohë ftesën për mbajtjen e mbledhjeve.

Me përjashtim të Komunës së Deçanit, të tri komunat tjera ftesës për mbledhje i kanë bashkangjitur edhe materialin e mbledhjes.

2 Ajo çfarë mbetet për tu dëshiruar është funksionalizimi i ueb faqeve zyrtare të komunave.

3 Në përgjithësi, aktet e miratuara në kuvend nuk publikohen në ueb faqet komunale.

4 Zyrtarët komunal, nuk përdorin rregullisht adresat zyrtare elektronike.

5 Kuvendi i Komunës së Rahovecit nuk është treguar shumë aktiv në mbajtjen e mbledhjeve, e po ashtu edhe në aspektin e vendimmarrjes.

6 Në Kuvendin e Komunës së Rahovecit dhe Deçanit kanë qenë prezentë raste të bojkotit

të mbledhjeve të kuvendit.

7 Komiteti për Komunitete nuk është funksional në Komunën e Rahovecit.

8 KPF në Komunën e Junikut nuk reflekton përbërjen e të gjitha entiteteve politike.

9 Konsiderohet pozitive gatishmëria e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për konsultime paraprake me organin mbikëqyrës para nxjerrjes së akteve komunale

10 Në Komunën e Junikut nuk respektohet me përpikëri Rregullorja e Punës së Kuvendit.

11 Komuna e Rahovecit, Junikut dhe Deçanit nuk kanë dërguar asnjë nga aktet e miratuara në Kuvend, për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës.

10 KKSB në asnjërën nga këto komuna nuk ka mbajtur numrin e nevojshëm të mbledhjeve të kërkuar me ligj.

KOMUNAT: GJILAN, KAMENICË, NOVOBËRDË DHE RANILLUG

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2011, në komunat: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug dukshëm shihet një shtim i aktivitetit dhe volumit të punës së tyre. Përqendrim më i madh i këtyre aktiviteteve vërehet në: planet rregullative, investimet kapitale, partneritetet publiko-private dhe projektet kapitale.

Komunat janë treguar të vëmendshme dhe bashkëpunuese me donatorët e huaj. Në këtë drejtim kanë arritur sukses në marrjen e fondeve të cilat janë përdorur për çështje të rëndësishme dhe me prioritet të veçantë për komunat.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Gjatë mbajtjes së mbledhjeve nuk ka munguar liria e shprehjes, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë transmetuar në mënyrë direkte dhe indirekte në televizionet lokale. Kjo u ka shërbyer qytetarëve që të njihen më për së afërmi me punën e të zgjedhurve të tyre.

Në shumicën e mbledhjeve të mbajtura kanë marrë pjesë: përfaqësuesit e OSBE-së, ICO-së, KFOR-it, USAID-it, DEM-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Gjatë periudhës janar - mars 2011, Kuvendet e Komunave kanë mbajtur gjithsej 27 mbledhje.




Fig.7. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Sa i përket numrit të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, ndërsa Kuvendet e Komunave: Novobërdë dhe Ranillug kanë mbajtur nga 6 mbledhje të rregullta.




Fig. 8. Krahasoni i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011

Pasqyra tabelare tregon krahasimin e numrit të mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave për periudhën janar-qershor të vitit 2010 me atë të vitit 2011.

Nga tabela vërejmë se në periudhën janar-qershor të vitit 2011, të gjitha kuvendet e komunave kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore duke respektuar LVL-në.

Gjithashtu, në këto komuna kanë qenë funksionale edhe komitetet e obligueshme.

Në Komunën e Gjilanit, KPF ka mbajtur 10 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 6 mbledhje, në Komunën e Kamenicës, KPF ka mbajtur 5 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 5 mbledhje. Në Komunën e Novobërdës, KPF ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 5 mbledhje, ndërsa në Komunën e Ranillugut, KPF ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur vetëm 1 mbledhje.

LVL ka paraparë mekanizma të drejtpërdrejtë me anë të të cilave




Fig. 9. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të Obligueshme në Komunat: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

qytetarëve i'u mundësohet e drejta për të ndikuar tek organet komunale në realizimin e interesave të tyre. Këtu bënë pjesë informimi publik dhe mbajtja e tubimeve publike me qytetarë. Me qëllim të forcimit të transparencës dhe krijimit të hapësirës që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes, komunat kanë realizuar tubime publike me qytetarë, të elaboruara si në vijim:

Në Komunën e Gjilanit janë mbajtur dy takime publike me qytetarë. Takimi i parë, ka pasur për temë investimet publike në infrastrukturës rrugore, kurse takimi i dytë, informimin e qytetarëve për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë.

Në Komunën e Kamenicës janë mbajtur dy takime publike me qytetarë. Takimi i parë ka qenë takim publik informativ lidhur me procesin e regjistrimit të popullsisë, ndërsa takimi i dytë lidhur me shqyrtimin e qarkores buxhetore për vitin 2012-2014.

Komuna e Novobërdës ka mbajtur një takim publik me qytetarë, ku është diskutuar buxheti i komunës. Komuna e Ranillugut ka mbajtur një takim publik me qytetarë. Në këtë takim është diskutuar për punën dhe arritjet e Komunës së Ranillugut për periudhën e vitit paraprak.




Fig. 10. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Me qëllim të funksionimit sa më efikas të komunave, kuvendet e komunave kanë miratuar akte të shumta dhe të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011, Kuvendet e Komunave kanë miratuar këtë numër të akteve:

Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 45 vendime, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar 30 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka miratuar 23 vendime dhe 1 rregullore, ndërsa Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar 20 vendime dhe 2 rregullore. Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në kuvendet e komunave, është gjithsej 122.

Në bazë të dhënave që kemi, krahasimi i periudhës janar-qershor të vitit 2010 me atë të periudhës 2011, rezulton të jetë i përafërt sa i përket numrit të akteve të miratuara në kuvend. Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në kuvendet e komunave për periudhën janar-qershor 2010 është 101, ndërsa për periudhën janar-qershor 2011 është gjithsej 122.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - për periudhën janar-qershor 2011, ka mbajtur mbledhje në Komunën e Gjilanit dhe të Kamenicës, ndërkohë që në Komunën e Novobërdës dhe të Ranillugut nuk është mbledhur asnjë herë.




Fig. 11. Numri i mbledhjeve të KKSB-ve në Komunitat: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug

Në Komunën e Gjilanit, KKSB ka mbajtur 2 mbledhje në të cilat është diskutuar gjendja politike dhe e sigurisë në Gjilan. Krahas kësaj, në Komunën e Kamenicës, KKSB gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011 ka mbajtur 2 mbledhje. Në këto mbledhje është diskutuar për çështjen e sigurisë në vijën kufitare të fshatit Karaqevë, ndërkohë që Komuna e Novobërdës dhe Ranillugut, ende nuk e kanë të themeluar këtë këshill.

U.A. nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL, përcakton që KKSB të mbledhet jo më pak se dhjetë herë në vit. Duke u bazuar në këtë, rrjedh konstatimi se komunat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 nuk e kanë përmbushur numrin e duhur të mbajtjes së takimeve të KKSB-ve.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

GJILAN

Komuna e Gjilanit gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje, prej tyre 8 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Ecuria e tyre përgjithësisht ka shkuar mirë dhe me një dinamikë të shtuar të punës. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve, si dhe me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Aktet të cilat miratohen në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Duhet theksuar se bashkëpunimi në mes të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe MAPL-së është i kënaqshëm dhe reciprok.

Pothuajse në shumicën e rasteve mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Opozita është treguar aktive dhe kritike në shumë çështje që janë diskutuar në kuvend. Roli i tyre ka qenë konstruktiv, i dobishëm dhe pozitiv gjatë këtyre proceseve. Po ashtu vlen të përmendet se Kuvendi i Komunës ka respektuar Rregulloren e punës.

Periodha janar – qershor 2011 ka rezultuar me miratimin e akteve të ndryshme, qoftë për nga prioritetet po ashtu edhe për nga rëndësia e tyre. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar 45 vendime. Disa nga aktet më të rëndësishme të cilat janë miratuar gjatë kësaj periudhe i kemi elaboruar në vijim:

Vendimi për dhënien e pëlqimit për Partneritet publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për mbeturina. Përmes këtij vendimi, me qëllim të investimeve në KRM Higjiena Gjilan, kanë filluar procedurat për themelimin e partneritetit publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për trajtimin e mbeturinave sipas ligjit mbi Partneritetet publiko private nr. 03 L-090, për realizimin e investimeve të reja sipas projektit për modernizimin e grumbullimit, transportimit, klasifikimit të mbeturinave dhe të kalohet në sistemin e trajtimit sipas standardeve të BE-së, deri në riciklim të mbeturinave.

Po ashtu vendim tjetër me rëndësi është vendimi për caktimin e kriterëve dhe procedurave për lidhjen e partneritetit publiko-privat dhe dhënien e të drejtës së ndërtimit në pronën komunale. Vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore 2012-2014 të Komunës së Gjilanit.

Të gjeturat

Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit janë evidentuar disa shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve.

Në mbledhjen e pestë të rregullt, Kuvendi ka miratuar dy vendime të kundërligjshme:

- Vendimin për formimin e komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës dhe Vendimin për hartimin e Rregullores për kompensimin e ish-zyrtarëve të lartë të komunës të cilët ushtrojnë funksion publik Nr. 16/4341, të datës 29.03.2011. MAPL, duke u bazuar në

kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L040, nenit 3 të Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 2004/2, ka bërë shqyrtimin e këtij vendimi dhe ka konstatuar se Vendimi për formimin e komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës dhe për hartimin e Rregullores për kompensimin e ish-zyrtarëve të lartë të komunës të cilët ushtrojnë funksion publik është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Barazi Gjinore. MAPL ka vlerësuar se organet kompetente komunale, gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës, duhet të përfillin përfaqësimin e femrave në këto Grupe, komisione, me qëllim të zbatimit të masave ligjore dhe afirmative të pjesëmarrjes së barabartë të femrave.

- Po ashtu, është marrë vendim për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit për Komunitete, gjë që bie në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në nenin 54.1 të LVL-së parashihet që "Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve". Ndërkohë që sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në listën e fundit të cilës i referohemi për numrin e popullsisë, Komuna e Gjilanit ka vetëm 4,058% të komunitetit pakicë.
- Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka nxjerr vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01.Nr.5817 për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrale Nr.1961-1 dhe Nr.1961-2.
- Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka nxjerr vendimin për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Qendrës për aftësimin profesional në Gjilan. MAPL duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të LVL-së Nr.03/L040, Ligjit Nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe pas shqyrtimit të hollësisht të këtij vendimi ka konstatuar se vendimi është i kundërligjshëm. Neni 5 pika 1, 5 pika 2 dhe 5 pika 3 e Ligjit Nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ka përcaktuar se Kuvendi i Komunës ka të drejtën t'i jep personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale për shfrytëzim deri në (dhjetë) 10 vite, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe mbi 10 vite e jo më shumë se (dyzet) 40 vite, pas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pëlqimit paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Neni 5 pika 6 e Ligjit Nr.03/L-226 ka përcaktuar se kriteret e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik nuk zbatohen për rastet kur kërkesa për dhënien në shfrytëzim bëhet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, përfaqësuesit diplomatik dhe konsullor, organizata dhe institucione ndërkombëtare që kanë marrëveshje me Republikën e Kosovës.
- Sa i përket konfliktit të interesit tek mbajtja e pozitave të dyfishta, në Komunën e Gjilanit është evidentuar një rast. Drejtori i Urbanizmit, para se të zgjedhej Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit, kishte hyrë në marrëdhënie pune me kompaninë A-DIZAJN, kompani kjo e cila ka pro-

jektuar plane rregulluese në Komunë. Drejtori ka heshtur lidhur me mbajtjen e pozitës së dyfishtë dhe këtë rast nuk e ka paraqitur tek Kryetari i Komunës deri në momentin kur është marrë informacioni që personi në fjalë ushtron dy pozita. Me këtë rast Kryetari i Komunës në takimin e rregullt të Këshillit Komunal të Drejtorëve ka njoftuar se ka miratuar dorëheqjen e Drejtorit të Urbanizmit, Naser Sylejmani, derisa në vend të tij ka emëruar zonjën Bahrie Mahmuti, arkitekte.

KAMENICË

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Kamenicës është thirrur 6 herë. Në këtë drejtim janë mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së mbledhjeve dhe se me kohë e ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Aktet të cilat janë miratuar në kuvend, dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Kuvendi i Komunës së Kamenicës, përgjithësisht ka funksionuar mirë, por me disa vërejtje. Mbledhjet e kuvendit nganjëherë janë të zgjatura, liria e fjalës keqpërdoret dhe diskutimet zgjaten pa ndonjë arsye.

Për çështje të cilat nuk kanë rëndësi dhe peshë të madhe diskutohet pa nevojë, dhe se mbledhjet marrin orientim tjetër.

Roli i opozitës është mjaft domethënës në zhvillimin dhe funksionimin e Kuvendit të Komunës. Në këtë drejtim, opozita është aktive dhe shumë debatuese në zhvillimet e kuvendit. Kuvendi i Komunës ka respektuar rregulloren e punës.

Duhet përmendur se në muajin prill kanë filluar punimet për ndërtimin e objektit të ri të komunës, ku Bashkimi Evropian ka ndarë mjete për të realizuar këtë projekt. Me përmirësimin e infrastrukturës, Komuna e Kamenicës do të ketë mundësinë që të ketë kushte më të mira, për punë më efikase dhe shërbime më cilësore për qytetarët.

Nga aspekti kuantitativ i miratimit të akteve komunale, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar gjithsej 28 vendime dhe 1 rregullore.

Vendimet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1) Vendimi për miratimin e raportit financiar të Komunës së Kamenicës për periudhën janar-dhjetor 2010.
- 2) Vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në Shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme të komunës.
- 4) Vendimi mbi aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore 2012-2014.

Të gjeturat

Sa i përket vendimeve të miratuara në kuvend, në Kuvendin e Komunës së Kamenicës janë evidencuar disa shkelje ligjore.

Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e pestë të rregullt, ka miratuar tri vendime të kundërligjshme:

- Vendimi për emërimin e Z. Dragisha Saviqit në postin zëvendëskryetarit të Komunës për Komunitete. Divizioni i Monitorimit ka konstatuar se ky vendim është në kundërshtim me nenin

61.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me të cilin parashihet që “Në komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë, do të kenë një nënkryetar për komunitete”. Ndërkohë që sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në listën e fundit të cilës i referohemi për numrin e popullsisë, Komuna e Kamenicës ka vetëm 4,670% të komunitetit pakicë.

- Vendimi për zgjedhjen e Z. Milkoviq Zhivijini në postin e zëvendës kryesuesit të Kuvendit për Komunitete. Ky vendim po ashtu bie në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në nenin 54.1 të LVL-së parashihet që “Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve”. Ndërkohë që sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në listën e fundit të cilës i referohemi për numrin e popullsisë, Komuna e Kamenicës ka vetëm 4,670% të komunitetit pakicë.
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim të përhershëm, pa kompensim, patundshmëria nga pronësia komunale e Poligonit të gjuajtjes-shejtarisë, Lidhjes Komunale të Shejtarisë në Kamenicë. Pas shqyrtimit të hollësishëm të këtij vendimi DM ka konstatuar se vendimi është i kundërligjshëm. Neni 5 pika 1, 5 pika 2 dhe 5 pika 3 e Ligjit Nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ka përcaktuar se Kuvendi i Komunës ka të drejtën t’i jep personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme publike komunale për shfrytëzim deri në (dhjetë) 10 vite, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe mbi 10 vite e jo më shumë se (dyzet) 40 vite, pas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pëlqimit paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Neni 5 pika 6 e Ligjit Nr.03/L-226 ka përcaktuar se kriteret e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik nuk zbatohen për rastet kur kërkesa për dhënien në shfrytëzim bëhet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, përfaqësuesit diplomatik dhe konsullor, organizata dhe institucione ndërkombëtare që kanë marrëveshje me Republikën e Kosovës.

NOVOBËRDË

Kuvendi i Komunës së Novobërdës gjatë periudhës raportuese ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Komuna i është përmbajtur afateve ligjore të përcaktuara nga LVL për mbajtjen e mbledhjeve dhe me kohë ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre. Aktet e miratuara në kuvend janë dërguar me kohë në adresë të MAPL-së. Edhe në Kuvendin e Komunës së Novobërdës sikurse në kuvendet paraprake, mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Duhet theksuar se në punimet e Kuvendit të Komunës vërehen disa mangësi sa i përket çështjeve procedurale. Disa nga mangësitë që kemi vërejtur është se konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit nuk bëhet fare nga ana e sekretarisë së kuvendit, shpesh ndodh që anëtarët e kuvendit të debatojnë pa e marrë lejen e kryesueses së kuvendit, po ashtu edhe minutat e mbajtjes së fjalimeve të anëtarëve të kuvendit janë të

zgjatura dhe të përsëritura duke vënë në pikëpyetje zbatimin e Rregullores së Punës së Kuvendit. Roli i opozitës është konstruktiv dhe mjaft aktiv, mirëpo anëtarët e kuvendit nga komuniteti serb fare pak inkuadrohen në çështjet të cilat diskutohen në kuvend, duke i bërë mjaft pasiv në këtë drejtim, përveç zëvendëskryesuesit të Kuvendit për Komunitete i cili është aktiv në punimet e Kuvendit.

Kur jemi tek miratimi i akteve të komunës, Kuvendi i Komunës së Novobërdës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 23 vendime dhe 1 rregullore.

Aktet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

1) Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Novobërdës neni 69 dhe 79. Me këtë vendim parashihet ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës së Novobërdës 01 nr. 02/359 të datës 17.05.2010

2) Vendim për implementimin e projektit, ndërtimi i kabinave në vend ndalesa të autobusëve në rrugët regjionale dhe lokale të komunës në vlerë prej 40,000€ të financuar nga Logosi zviceran me participim 20% nga komuna. Ky vendim parasheh ndërtimin e kabinave në vend ndalesa të autobusëve në rrugët regjionale dhe lokale të komunës me vlerë 40.000€ të financuar nga Logosi zviceran dhe me participim 20% nga komuna.

3) Vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore 2012-2014.

Të gjeturat

- Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit nuk bëhet fare nga ana e sekretarisë së kuvendit.
- Anëtarët e kuvendit debatojnë pa e marrë lejen nga Kryesuesja e Kuvendit.
- Komuniteti serb nuk inkuadrohet në diskutimet që bëhen në mbledhjet e kuvendit.
- KKSBB ende nuk është themeluar në këtë komunë.

RANILLUG

Kuvendi i Komunës së Ranillugut gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011 është mbledhur gjithsej 6 herë. Sa i përket njoftimit dhe mbajtjes së mbledhjeve Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka përmbyshur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve, si dhe me kohë ka njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës. Rendi i ditës dërgohet përmes emailit zyrtar dhe çdo herë është përkthyer në gjuhën shqipe. Gjatë monitorimit të mbledhjeve të kuvendit, përkthyesi është prezent dhe bënë përkthimin e mbledhjeve nga gjuha serbe në atë shqipe. Po ashtu, edhe aktet të cilat miratohen në kuvend, përkthehen në gjuhën shqipe dhe dërgohen me kohë në adresë të MAPL-së. Kuvendi i Komunës së Ranillugut shquhet për një efikasitet dhe efektivitet të punës së tyre. Përgjithësisht gjendja reale është e kënaqshme, opozita është shumë aktive, e hapur, konkrete në kritika dhe në shtjellimin e gjërave. Por duhet cekur faktin se Kuvendi i Komunës ka mungesë të pajisjeve për komunikim. Për zgjidhjen e këtij problemi, USAID ka ofruar mbështetjen me 80% të mjeteve për pajisje me aparaturë, ndërsa komuna do të participoj me 20%. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Ranillugut ka miratuar gjithsej 21

vendime dhe 2 rregullore.

Aktet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1) Vendimi mbi plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa, tarifa dhe gjoha komunale.
- 2) Vendimi mbi rritjen e buxhetit në vlerë prej 22,581,16 euro. Ky vendim parasheh që të hyrat vetanake fiskale për vitin 2010-të sipas buxhetit kanë qenë në vlerë prej 21.000,00 euro, kurse të hyrat vetanake të realizuara për vitin 2010-të kanë qenë në vlerë prej 43.581,16 euro, çka do të thotë se nga planifikimi janë realizuar më tepër në vlerë prej 22.581,16 euro.
- 3) Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Ranillugut.
- 4) Vendimi mbi ndalimin e pirjes së duhanit në institucionet publike të Komunës së Ranillugut.

Të gjeturat

- Në Komunën e Ranillugut ende nuk është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.
- Selia e Komunës së Ranillugut gjendet në fshatin Domoroc afër vijës kufitare me Republikën e Serbisë. Një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 5.5. të Ligjit për Kufijtë Administrativ (Ligji Nr. 03/L-041) me të cilin parashihet që selia e Komunës së Ranillugut të jetë në Ranillug.

● Konkluzione

1 Komunitat përgjithësisht kanë dërguar me kohë ftesën për mbajtjen e mbledhjeve.

2 Komuna e Gjilanit e bënë publikimin e akteve komunale në ueb faqe, ndërsa komunat e tjera nuk e bëjnë një gjë të tillë.

3 KKSB në Komunën e Novobërdës dhe Ranillugut ende nuk është themeluar.

4 KKSB në Komunën e Gjilanit dhe Kamenicës, nuk e kanë mbajtur numrin e nevojshëm të mbledhjeve të kërkuar me ligj.

KOMUNAT: FERIZAJ, KAÇANIK, SHTIME, SHTËRPCË, GRAÇANICË

Mbledhjet e mbajtura

Kuvendet e komunave: Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë dhe Graçanicë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 kanë funksionuar normalisht dhe nuk ka pasur raste të bojkotimit të mbledhjeve nga ndonjë grup parlamentar apo dështim të seancës në këto komuna.

Opozita në këto komuna ka qenë konstruktive në marrjen e vendimeve si dhe aktive në ngritjen e çështjeve në kuvend, duke marrë pjesë aktivisht në diskutime gjatë shqyrtimit të pikave të rendit të ditës si dhe në marrjen e vendimeve.

Kuvendet e këtyre komunave gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur gjithsej 28 mbledhje, nga to 26 janë të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme.




Fig. 12. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Graçanicë

Nga figura e mësipërme shihet se Kuvendet e komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtërpçë, kanë mbajtur nga 5 mbledhje të rregullta, Komuna e Shtimes ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme.

Kur bëjmë krahasimin e mbajtjes së mbledhjeve për periudhën janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011, konstatojmë se kuvendet e këtyre komunave kanë qenë më pakë aktive gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Derisa në vitin

2010 kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur 36 mbledhje, në periudhën e njëjtë të vitit 2011 ato kanë mbajtur 28 mbledhje. Por, në përgjithësi të gjitha komunat janë brenda kornizës ligjore për numrin e mbajtjes së mbledhjeve.

Në tabelë janë paraqitur numri i mbledhjeve të zhvilluara gjatë periudhës janar – qershor 2010 dhe 2011:




Fig. 13. Krahasoni i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011

Konkretisht, këto komuna gjatë periudhës janar –qershor 2010 kanë mbajtur këtë numër të mbledhjeve: Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, ndërsa Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme.

Sa i përket njoftimit për mbledhjet e kuvendeve, komunat me kohë i kanë dërguar ftesat dhe materialet shitesë, konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në të gjitha Komunat tjera përveç asaj të Graçanicës bëhet përkthimi i materialeve në gjuhët zyrtare.⁸

Komiteteve të obligueshme, në këto komuna kanë mbajtur numërin e mbledhjeve si në grafik:

Nga ky pasqyrim shihet që Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Ferizajt, Shtërpçës dhe Graçanicës është mbledhur nga 5 herë, ndërkohë që në Komunën e Shtimes ka mbajtur 6 mbledhje.




Fig.14. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komunat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Graçanicë

⁸Shih Komunën e Graçanicës

Komiteti për Komunitete, në Komunën e Ferizajt, Shtimes, Shtërpçës dhe Graçanicës ka qenë funksional dhe kanë mbajtur takime të rregullta, përveç Komunës së Kaçanikut ku Komiteti për Komunitete nuk ka qenë funksional dhe nuk ka mbajtur asnjë takim.

Komiteti për Komunitete, në Komunën e Ferizajt dhe Shtimes kanë mbajtur nga 6 mbledhje, në Komunën e Graçanicës dhe Shtërpçës 4 mbledhje, ndërsa në Komunën e Kaçanikut, Komiteti për Komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.




Fig.15. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Graçanicë

Kuvendet e Komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Graçanicë janë treguar mjaft aktive në miratimin e akteve. Në përgjithësi kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar 103 vendime dhe 13 rregullore, më konkretisht në Kuvendin e Komunës së Ferizajt janë miratuar 16 vendime, në Shtërpçë 14 vendime, në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut 13 vendime, në Kuvendin e Komunës së Shtimes 30 vendime dhe 5 rregullore, kurse në Kuvendin e Komunës së Graçanicës janë miratuar 40 vendime dhe 7 rregullore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, gjatë kësaj periudhe kuvendet e këtyre komunave kanë qenë aktive në nxjerrjen e vendimeve si dhe miratimin e rregulloreve komunale.

Sa i përket transparencës në lidhje me aktet miratuara në Kuvend, ende ka nga ato komuna të cilat nuk ndërmarrin veprime konkrete për publikimin e tyre në ueb faqet zyrtare. Komuna e Ferizajt dhe Kaçanikut kanë qenë të rregullta në këtë drejtim, duke bërë publikimin e të gjitha vendimeve dhe rregulloreve të miratuara në kuvend. Komuna e Shtimes ka bërë publikimin e pjesërisht të tyre duke publikuar vetëm rregulloret e jo edhe vendimet, ndërsa Komuna e Graçanicës publikimin e akteve e ka bërë vetëm në gjuhën serbe. Komuna Shtërpçës asnjë nga aktet e miratuara nuk i ka publikuar në ueb faqen zyrtare.

Gjatë periudhës janar – qershor 2011, jo të gjitha komunat janë kujdesur në organizimin e tubimeve publike me qytetarë. Nga një takim publikë me qytetarë kanë mbajtur Komuna e Ferizajt dhe Shtërpçës, ndërsa Komunat: Shtime, Kaçanik dhe Graçanicë ende nuk kanë mbajtur takime publike me qytetarë.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, gjatë këtij gjashtëmujori të 2011, komunat nuk janë treguar aktive në mbajtjen e takimeve publike me qytetarë.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - Në periudhën e gjashtëmuorit të parë 2011, KKSBB-të e komunave: Ferizaj, Shtime, Graçanicë, kanë funksionuar normalisht dhe janë takuar sipas nevojës, ndërsa në Komunën e Shtërpçës, KKSBB nuk ka qenë funksionale. Në Komunën e Kaçanikut, KKSBB edhe pse në fillim të këtij viti ka pasur vështirësi për tu takuar për shkak të mosmarrëveshjeve në mes kryetarit të Komunës dhe komandantit të stacionit policor në Kaçanik, tanimë janë zgjidhur këto pengesa duke funksionalizuar Këshillin.




Fig. 16. Numri i mbledhjeve të KKSBB-ve në Komunitat: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Graçanicë

Grafikoni i mësipërm tregon që KKSBB në Komunën e Ferizajt ka mbajtur 4 mbledhje, në atë të Shtimes 5, Kaçanik 2 mbledhje, në Komunën e Graçanicës dhe të Shtërpçës nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

FERIZAJ

Kuvendi Komunës së Ferizajt gjatë kësaj periudhe ka funksionuar normalisht dhe nuk ka pasur raste të bojkotimit të mbledhjeve nga ndonjë parti politike. Ajo çka e karakterizon këtë gjashtëmujorë Kuvendin e Komunës së Ferizajt është transmetimi i drejtpërdrejt i mbledhjeve të kuvendit në televizionet lokale, duke e bërë kuvendin mjaft transparent para qytetarëve. Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 5 mbledhje, me ç'rast ka miratuar 16 vendime dhe 1 rregullore.

Në Kuvendin e Komunës së Ferizajt, për këtë periudhë nuk ka pasur asnjë rast që anëtarët e Kuvendit të paraqesin konfliktin e interesit për ndonjë nga çështjet e zhvilluara në Kuvend.

Pas nënshkrimit të memorandumit në mes MAPL-së dhe MAP-it në lidhje me pozitat e dyfishta, gjatë kësaj periudhe në Kuvendin e Komunës së Ferizajt nuk është paraqitur asnjë rast i tillë.

Kuvendi i Komunës së Ferizajt është treguar aktiv në nxjerrjen e vendimeve me interes për qytetarët. Më tepër prezente janë vënë re vendimet mbi dhënien në shfrytëzim të pronave dhe shpalljen e tyre me interes të përgjithshëm. Kemi shënuar raste kur janë nxjerrë vendime për prona të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së.

Gjatë kësaj periudhe kuvendi ka miratuar edhe raportin e punës së qeverisë komunale. Ky raport është prezantuar nga Kryetari Komunës, ku më pas është zhvilluar një debat konstruktiv nga anëtarët e kuvendit.

Të gjeturat

- Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur më 24.05.2011, është marrë Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale 517, vendi i quajtur "Kodra e Kazermës" pasuri shoqërore nën menaxhim të AKP-së, me qëllim që një pjesë e saj të destinohet për ndërtimin e Agjensionit të Inteligjencës së Kosovës.

KAÇANIK

Kuvendi Komunës së Kaçanikut në këtë periudhë ka mbajtur 5 mbledhje në të cilat ka miratuar 13 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë rregullore. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka shqyrtuar shumë çështje me interes për qytetarët e komunës ku rol të rëndësishëm ka luajtur edhe opozita e cila ka qenë konstruktive në shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Ndër vendimet që ka miratuar Kuvendi janë: Vendimi për fillimin e hartimit dhe planit rregullues për zonën e parë urbane të qytetit të Kaçanikut, pastaj vendimi për formimin e komisionit për grumbullimin e materialeve dhe ngritjen e padisë kundër Serbisë për dëmet e bëra në Komunën e Kaçanikut. Kuvendi ka shqyrtuar edhe raportin e punës së Kryetarit për periudhën janar-dhjetor 2010.

Të gjeturat

Sa i përket shkeljeve ligjore gjatë këtij gjashtëmujori Divizioni i Monitorimit ka evidentuar një shkelje ligjore.

- Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2011, ka marrë vendim për ndalimin e organizimit të disa lojërave të fatit në territorin e Komunës së Kaçanikut. Ky vendim bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Lojërat e Fatit.

SHTIME

Kuvendi i Komunës së Shtimes gjatë gjashtëmujorit të parë 2011 ka mbajtur 6 mbledhje, ku në këto mbledhje janë miratuar 35 vendime dhe 1 rregullore. Kuvendi ka miratuar edhe 30 kërkesa të ardhura në kuvend nga ana e qytetarëve.

Komuna e Shtimes ka marrë vendim për miratimin e planit rregullues për qytetin e Shtimes, si dhe ka marrë vendim për ngritjen e Komisionit i cili do të bëjë vlerësimin e dëmeve të luftës. Kuvendi ka vendosur edhe për shumë kërkesa të qytetarëve të cilat i'u kanë adresuar kuvendit, ku shumica kanë pasur të bëjnë me ndihmën që kanë kërkuar nga Komuna për t'u ndihmuar në ndërtimin e shtëpive. Të gjitha këto kërkesa Kuvendi i ka adresuar në drejtorinë përkatëse për t'i shikuar mundësitë buxhetore dhe për t'iu dalë në ndihmë këtyre familjeve.

Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar kornizën afatmesme buxhetore 2012-2014. Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar Rregulloren për mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave, lagjeve urbane.

Të gjeturat

Sa u përket shkeljeve ligjore, MAPL ka evidentuar disa shkelje ligjore në marrjen e vendimeve në kuvend, për të cilat Departamenti Ligjor i MAPL-së ka kërkuar rishqyrtimin e tyre nga Komuna e Shtimes. Vendimet për të cilat është kërkuar rishqyrtimi i tyre në Kuvendin e Komunës së

Shtimes janë:

- 1) Vendimi për mosaprovimin e propozim-vendimit për caktimin e mëditjeve për anëtarët e kuvendit, komiteteve dhe komisioneve.
- 2) Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale z. Gafurr Rexhaj.
- 3) Vendim për dhënien e pëlqimit në parim për shfrytëzimin e pronës së patundshme të ekonomisë pyjore në Petrovë.
- 4) Vendim për dhënien e pëlqimit në parim për shfrytëzimin e pronës së patundshme të ekonomisë pyjore në Belinc.
- 5) Vendim për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

- Në Kuvendin e Komunës së Shtimes, nga anëtarët e Kuvendit nuk është respektuar procedura e marrjes së fjalës, e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Shpeshherë janë vërejtur ndërhyrjet nga anëtarët e kuvendit gjatë diskutimeve, duke marrë fjalën pa i'u dhënë paraprakisht nga ana e kryesuesit. Në kuvend janë vërejtur po ashtu ndërhyrjet nga ana e kryetarit të Komunës edhe në rastet kur nuk është kërkuar sqarim nga ana ai.
- Komuna e Shtimës ka bërë publikimin e pjesërishëm të akteve komunale në ueb-faqen zyrtare.

SHTËRPECË

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës gjatë këtij gjashtëmujori muhori ka funksionuar normalisht. Në mbledhje kanë marrë pjesë të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Nuk ka pasur raste të bojkotimit të mbledhjeve të kuvendit, e po ashtu përkthimi është siguruar. Kuvendi i Komunës së Shtërpçës ka mbajtur 6 mbledhje, me ç'rast ka miratuar 7 vendime. Ndër vendimet e miratuara është Vendimi për themelimin e zyrave të vendit në fshatrat Sevcë dhe Brod. Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e qeverisë komunale për periudhën janar – dhjetor 2010. Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Shtërpçës ka pasur ndryshime në ekzekutiv. Dy nga drejtorët kanë dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit duke eliminuar mundësinë për mbajtje të pozitave të dyfishta. Njëri nga drejtorët është zgjedhur deputet në parlamentin e Kosovës, ndërsa tjetri është emëruar Ministër në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete.

Të gjeturat

Në Komunën e Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2011 janë marrë 3 vendime të kundërligjshme, të cilat janë adresuar për shqyrtim në Departamentin Ligjor të MAPL-së. Departamenti Ligjor i MAPL-së pas shqyrtimit të tyre, i ka cilësuar si të kundërligjshme dhe ka kërkuar rishqyrtimin e tyre në Kuvendin e Komunës së Shtërpçës. Vendimet për të cilat DL ka kërkuar rishqyrtimin e tyre janë:

- 1) Vendim për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik për ndërtimin e terrenit sportiv në fshatin Brod.
- 2) Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e gjykatës komunale në Shtërpçe.
- 3) Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sportit dhe terrenit të futbollit.

- KKSBB nuk ka qenë funksionale në Komunën e Shtërpçës.

GRAÇANICË

Kuvendi Komunës së Graçanicës gjatë periudhës janar-qershor 2011, ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, në të cilat ka miratuar 50 vendime dhe 7 rregullore. Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka miratuar Planin Rregullativ për zonën ku do të ndërtohet një sipërfaqe biznesi e quajtur Medical Group K. O Livagje si dhe Planin Rregullativ për ndërtimin e Klinikës së Radiologjisë K. O Suhodoll.

Kuvendi gjithashtu ka miratuar vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë jo bujqësore.

Komuna e Graçanicës ka qenë aktive në miratimin e rregulloreve siç është:

- 1) Rregullorja për caktimin e kohës së punës të subjekteve afariste që kryejnë aktivitete biznesi në Komunën e Graçanicës.
- 2) Rregullorja mbi certifikatën për punë me pije alkoolike në territorin e Komunës së Graçanicës.
- 3) Rregullorja për mbikëqyrje higjienike sanitare të ushqimeve dhe mjeteve tjera për përdorim të përgjithshëm.

Të gjeturat

- Komuna e Graçanicës ende nuk e ka emëruar nënkryetarin e Komune Komunës për Komunitete.
- Komuna e Graçanicës megjithëse ka filluar t'i dërgoj ftesat për mbledhje të kuvendit në gjuhën shqipe, materialet e parapara për shqyrtim në mbledhje nuk i ka përkthyer në gjuhët zyrtare me arsyetimin e mungesës së përkthyesve, duke rënë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Përdorim të Gjuhëve.
- Kjo komunë ende vazhdon të mos dërgoj vendimet dhe rregulloret për vlerësim të ligjshmërisë në Departamentin Ligjor të MAPL-së.
- KKSBB nuk ka qenë funksionale në Komunën e Graçanicës.
- Në Kuvendin e Komunës së Graçanicës nuk sigurohet përkthimi.
- Komuna e Graçanicës ka bërë publikimin e pjesërisht të akteve komunale në ueb-faqen zyrtare.

Konkluzione

1 Komunitet kanë funksionuar normalisht dhe nuk janë shënuar raste të bojkotimit të mbledhjeve.

2 Gjatë kësaj periudhe nuk është shënuar asnjë rast i pozitive të dyfishta.

3 Është për tu vlerësuar roli konstruktiv i opozitës në zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

4 Divizioni i Monitorimit ka evidentuar 9 raste të shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve në Kuvend.

5 Komuna e Graçanicës nuk përkthen të gjitha materialet në gjuhët zyrtare ashtu siç parashihet me Ligjin për Përdorim të Gjuhëve.

6 Në Kuvendin e Komunës së Shtimes ka vështirësi në zbatimin e Rregullores së Punës.

7 Në komunën e Graçanicës dhe Shtërpçës nuk kanë qenë funksionale Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

KOMUNAT: PRIZREN, SUHAREKË, MAMUSHË, DRAGASH DHE PARTESH

Mbledhjet e mbajtura

Përgjithësisht, Kuvendet e Komunave: Prizren, Suharekë, Mamushë dhe Partesh, gjatë periudhës janar-qershor 2011, kanë qenë të rregullta në mbarëvajtjen dhe funksionimin e punës së tyre, duke respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, në këto komuna shihet një shtim i aktivitetit dhe volumit të punës. Në aspektin kuantitativ, kuvendet e komunave kanë përmbushur obligimin ligjor në mbajtjen e mbledhjeve si dhe me kohë e kanë njoftuar MAPL-në për mbajtjen e tyre, duke respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve.

Pothuajse në shumicën e rasteve mbledhjet kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, ICO-së, KFOR-it, USAID-it, DEM-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Sipas nenit 43.2 të LVL-së, Kuvendi i Komunës, mbanë së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit. Në vijim kemi paraqitur në formë grafike numrin e mbledhjeve të mbajtura në komuna.




Fig. 17. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash, Partesh

Në bazë të paraqitjes së mësipërme del se Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur 8 mbledhje, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka mbajtur 7 mbledhje, Kuvendi i Komunës së Mamushës dhe Dragashit kanë mbajtur nga 6 mbledhje, ndërsa Kuvendi i Komunës së Parteshit ka mbajtur 5 mbledhje që do të thotë se këto komuna kanë mbajtur numrin e mbledhjeve konform LVL-së.

Duke bërë krahasimin me gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak, kuvendet e këtyre Komunave në këtë gjashtëmujor kanë mbajtur numër më të madh të mbledhjeve.




Fig. 18. Krahasoni i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011

Sipas tabelës së mësipërme, gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, komunat në fjalë kishin mbajtur 17 mbledhje të Kuvendit, ndërsa këtë vit kanë mbajtur 32 mbledhje.

Gjithashtu në këto komuna kanë qenë funksionale edhe komitetet obligative.




Fig. 19. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komunat: Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash, Partesh

Nga ky grafik del që në Komunën e Prizrenit, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 7 mbledhje ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 3 mbledhje, në Komunën e Suharekës Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa Komiteti për Komunitete 4 mbledhje, në Komunën e Mamushës KPF ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 5 mbledhje, në Dragash KPF ka mbajtur 6 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 6 dhe në Komunën e Parteshit, KPF ka mbajtur 4 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 1.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, Komuna e Prizrenit, Parteshit, Dragashit dhe Suharekës kanë mbajtur nga një tubim

publik me qytetar, ndërsa në Komunën e Mamushës megjithëse është thirrur një tubim, nuk është mbajtur për shkak të pjesëmarrjes së vogël të qytetarëve. Kuvendet e Komunave: Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash dhe Partesh, gjatë kësaj periudhe kanë miratuar vendime me rëndësi dhe me interes për qytetarët, mirëpo nuk duhet përjashtuar edhe paraqitjen e disa shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve.




Fig. 20. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash, Partesh

Sipas të dhënave grafike del që Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka miratuar 32 vendime, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka miratuar 26 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Mamushës ka miratuar 11 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar 4 vendime, ndërsa Kuvendi i Komunës së Parteshit ka miratuar 13 vendime dhe 6 rregullore.

Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nga aspekti kuantitativ i miratimit të akteve komunat këtë gjashtëmujor kanë miratuar më shumë akte.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi – KKSBB gjatë kësaj periudhe ka qenë funksionale vetëm në Komunën e Prizrenit dhe Suharekës. Megjithatë Komuna e Parteshit ka themeluar KKSBB-në ende nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Gjithashtu Komuna e Mamushës dhe e Dragashit nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje të KKSBB-së. Në vijim kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të mbajtura të KKSBB-së:




Fig. 21. Numri i mbledhjeve të KKSBB-ve në Komunat: Prizren, Suharekë, Mamushë, Dragash, Partesh

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendit

PRIZREN

Kuvendi i Komunës së Prizrenit, gjatë periudhës janar-qershor 2011, ka qenë i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe njëkohësisht ka treguar koherencë gjatë zhvillimit të punimeve. Rezultat i këtij procesi është se në periudhën janar-qershor të vitit 2011, anëtarët e kuvendit nga radhët e opozitës, pas një bojkoti disa mujor të Kuvendit të Komunës, janë rikthyer punimeve të kuvendit dhe kanë dalë me propozime për plotësimin e Komiteteve funksionale të Kuvendit. Në këtë drejtim është shënuar një hap pozitiv drejt normalizimit dhe funksionalizimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Gjatë periudhës në fjalë, Kuvendi ka miratuar gjithsej 33 vendime. Tek çështja e emblemës së Komunës së Prizrenit, është arritur progres ku anëtarët e Kuvendit gjatë kësaj periudhe kanë nxjerr 4 vendime:

1) Vendimin për plotësimin e Komisionit Statutar për ndryshimin e Statutit të Komunës në pajtim me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese; 2) Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Prizrenit; 3) Vendimin për vënien e tij në diskutim publik të Statutit të Komunës së Prizrenit si dhe 3) Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Prizrenit.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë themeluar këto komitete: Komiteti për Barazi Gjinore, Komiteti Komunal i Banimit (KKB), Komiteti i Arsimit dhe Kulturës, Komiteti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe Komiteti për persona me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, mbledhjet e kuvendit kanë filluar dhe janë zhvilluar në bazë të rendit të ditës.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, KFOR-it, USAID-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur.

Sa i përket politikave komunale, Komuna e Prizrenit i ka dhënë hapësirë më tepër mbështetjes dhe zhvillimit të bujqësisë. Në këtë drejtim, komuna ka mbështetur zhvillimin e bujqësisë në të gjithë sektorët e saj, posaçërisht bujqit e komunës duke i subvencionuar në farëra gruri dhe fidane.

Po ashtu, vlen të ceket implementimi i projekti për ndriçimin eficient të qytetit dhe rrugëve periferike.

Vendimet të cilat janë miratuar gjatë kësaj periudhe dhe të cilat konsiderohen të jenë më të rëndësishme janë:

- 1) Vendimi për plotësimin e Komisionit Statutar për ndryshimin e Statutit të Komunës në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.
- 2) Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Prizrenit si dhe marrja e vendimit për vënien e tij në diskutim publik.
- 3) Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores komunale për aplikimin e tatimit në pronën e paluajtshme në Komunën e Prizrenit me Nr.01/011-5059, të datës 29.09.2008.
- 4) Vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban për "Varrezat e Qytetit të Prizrenit" dhe për vënien e të njëjtit në diskutim publik.
- 4) Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Prizrenit.

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka organizuar një takim publik me qytetarë.

Të gjeturat

Divizioni i Monitorimit gjatë kësaj periudhe ka evidentuar dy shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

- Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit për formimin e komisionit për statusin e ish-anëtarëve të kuvendit në përbërje prej 4 anëtarësh të gjinisë mashkullore (pa përfshirjen e gjinisë femërore në përbërje të këtij komisioni). Divizioni i Monitorimit konsideron se ky vendim është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Barazi Gjinore. Vendimi në fjalë është në shqyrtim e sipër nga MAPL.

SUHAREKË

Komuna e Suharekës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 ka funksionuar normalisht. Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Në shumicën prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, KFOR-it, USAID-it, mediet dhe qytetarët e interesuar.

Gjatë periudhës në fjalë, nuk është evidentuar ndonjë rast i mbajtjes së pozitave të dyfishta si dhe nuk janë parë raste të konfliktit të interesit në çështjet që lidhen me punën e Kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e kuvendit të mbajtur në muajin mars ka miratuar edhe Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2010.

Gjatë periudhës së raportimit, Komuna e Suharekës ka lidhur marrëveshje për binjakëzimin e dy komunave, atë të qytetit të Fellbahut të Republikës së Gjermanisë dhe të qytetit të Suharekës të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të aktivitetit të saj, Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 ka miratuar gjithsej 26 vendime dhe 1 rregullore.

Aktet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1) Vendimi mbi legalizimin e objekteve.
- 2) Vendimi mbi formimin e komisionit për vlerësimin apo mbikëqyrjen e investimeve kapitale të re-alizuara gjatë vitit 2010 nga ana e Komunës së Suharekës.
- 3) Vendimi për hartimin e Planit Rregullues Urban për lagjen "Rosula".
- 4) Vendimi për hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën qendrore banimore.
- 5) Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve pa leje.
- 6) Vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2012-2014.
- 7) Vendimi mbi lejjimin e ndarjes së parcelave kadastrale në zonat urbane.

8) Vendimi mbi plotësim-ndryshim të këshillit të ekspertëve për planin zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planet rregulluese urbane.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për qytetarët që të jenë më afër procesit të vendimmarrjes, Komuna e Suharekës ka organizuar 1 tubim publik me qytetarë.

Të gjeturat

- Komuna e Suharekës nuk është treguar shumë kooperuese me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

MAMUSHË

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Sa i përket punimeve të kuvendit, në mbledhjen e 28 janarit 2011, Kuvendi i Komunës së Mamushës ka shqyrtuar raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2010. Duke pasur parasysh që në këtë komunë nuk ka plan urbanistik, është lidhur marrëveshja e mirëkuptimit me UN- HABITAT-in, me të cilën marrëveshje Republika e Turqisë do të ofroj ndihmë teknike në implementimin e planeve urbanistike.

Gjatë kësaj periudhe, Komuna e Mamushës ka lidhur marrëveshjen e mirëkuptimit me UN- HABITAT-in, ky projekt do të përkrahet me ndihmën teknike edhe nga Republika e Turqisë. Projekti ka të bëjë me planin urbanistik të kësaj komune.

Komuna e Mamushës ka organizuar 1 takim publik me qytetarët, por si rezultat i pjesëmarrjes së vogël të qytetarëve, takimi në fjalë ishte anuluar.

Në kuadër të aktivitetit normativ, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit.

Gjatë monitorimit të mbledhjeve të kuvendit nuk është evidentuar ndonjë parregullsi apo bojkot i mbledhjes nga ana e anëtarëve të kuvendit.

Komuna e Mamushës, në përgjithësi aktet për shqyrtim të ligjshmërisë i dërgon brenda afateve të parapara ligjore në Ministrinë përkatëse.

Në këtë komunë gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit, qoftë tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, apo me rastin e nxjerrjes së vendimeve në Kuvend.

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 10 vendime dhe 1 rregullore. Ndër to mund të përmendim:

- 1) Vendimin për binjakëzim me Komunën e Margegaj nga Republika e Shqipërisë.
- 2) Vendimin për binjakëzim me Komunën e Adana Ceyhan nga Republika e Turqisë.
- 3) Vendimin për binjakëzim me Komunën e Konacik nga Republika e Turqisë.
- 4) Vendimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2012-2014.
- 5) Vendimin për formimin e komisionit për logon e komunës.

- 6) Vendimin për miratimin e rregullores për mbrojtjen e mjedisit.
- 7) Vendimin për vazhdimin e vendimit për zbritjen e taksave komunale.

Të gjeturat:

- Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, sigurohet përkthim simulant, mirëpo në mungesë të mjeteve teknike pamundësohet përkthimi për të gjithë.

DRAGASH

Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 ka qenë funksional dhe ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.

Ftesat për mbledhje kryesisht janë dërguar me kohë, por nuk duhet përjashtuar edhe rastet e vonësës së ftesës për mbledhjet e kuvendit të kësaj komune.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, kuvendi i kësaj komune, ka shqyrtuar dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit të Biodiversitetit të Komunës së Dragashit 2011-2015.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kjo komunë ka miratuar raportin e punës së Kryetarit dhe organeve komunale për vitin 2010 dhe planin e punës për vitin 2011.

Sa i përket akteve të miratuara, Kuvendi i Komunës së Dragashit, gjatë kësaj periudhe ka miratuar 4 vendime, ndërsa rregullore gjatë kësaj periudhe nuk ka miratuar.

Ndër vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë:

- 1) Vendimi për bashkimin e zyrës së komuniteteve dhe kthimit.
- 2) Vendimi për heqjen e pagesës së deritashme të mëditjeve, udhëtimeve zyrtare të shërbyesve civil dhe zyrtarëve tjerë të Komunës së Dragashit, brenda territorit të Komunës dhe Kosovës.

Të gjeturat

- Komuna e Dragashit, aktet e miratuara nuk i ka publikuar në ueb faqen zyrtare.
- Komuna e Dragashit ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendit për themelimin e grupit punues të kuvendit të komunës së Dragashit në përbërje prej pesë(5) anëtarëve, me detyrë që të shqyrtoj dhemiratoj Planin Lokal të Veprimit të Biodiversitetit të Komunës së Dragashit 2011-2015. Vendimi është kthyer për rishqyrtim nga MAPL, mirëpo komuna ende nuk ka marrë asnjë veprim konform shkresës së Ministrisë.

PARTESH

Kuvendi i Komunës së Parteshit gjatë periudhës së gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 ka qenë funksional dhe ka mbajtur 5 mbledhje. Këto mbledhje kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Komuna e Parteshit ka dërguar me kohë ftesën për mbajtje të mbledhjeve. Gjatë monitorimit të mbledhjeve të kuvendit nuk është evidentuar ndonjë parregullsi apo bojkot i

mbledhjes nga ana e anëtarëve të kuvendit. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kuvendi i Komunës ka miratuar 15 vendime dhe 4 rregullore. Komitetet obligative në këtë komunë kanë qenë janë funksionale. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur 1 mbledhje. Në këtë komunë gjatë periudhës janar-qershor 2011 nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit, qoftë tek ushtrimi i pozitave të dyfishta, apo me rastin e votimit për ndonjë nga çështjet e diskutuara në Kuvend. Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe Komuna e Parteshit, ka formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Përveç kësaj, Komuna e Parteshit ka mbajtur edhe një tubim publik me qytetarë.

Ndër vendimet e miratuara mund të përmendim:

1. Vendimin për formimin e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Vendimin për ndarjen e parcelave në shfrytëzim personave të zhvendosur.
3. Vendimin për miratimin e Rregullores për pastërti dhe mbrojtje të mjedisit.
4. Vendimin për miratimin e Planit Aksionar për mbrojtje kundër zjarrit në territorin e Komunës së Parteshit.
5. Vendimin për miratimin e Rregullores për tatim në prone 22/10

Të gjeturat

- Megjithëse me nenin 5.5 të Ligjit për Kufijtë Administrativ Nr. 03/L-041, parashihet që Komuna e Parteshit të ketë selinë në Partesh, gjendja faktike rezulton të jetë ndryshe. Aktualisht objekti komunal i Parteshit gjendet në fshatin Pasjan. Komuna e Parteshit lidhur me këtë ka dhënë arsyetimin se objekti është caktuar të jetë Pasjan për shkak të mungesës së pronës komunale për ndërtimin e objektit të komunës në Partesh. Duhet theksuar se Kuvendi i Komunës së Parteshit me shumicë votash dhe në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave nr.03/L-041 në dhjetor të vitit 2010 kishte miratuar propozimin për ndryshimin e selisë së Komunës nga Parteshi në Pasjan që është pjesë e territorit administrativ të Komunës së Parteshit. Ndërkohë që, MAPL nga Kryetari i Komunës së Parteshit ka pranuar kërkesën për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Komunës së Parteshit. Pas shqyrtimit të kësaj shkrese, MAPL i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shqyrtoj dhe të marr vendim për lejimin e ndërtimit të objektit komunal në Pasjan të Komunës së Parteshit dhe të procedoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës amendamentimin e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave nr.03/L-041, duke ndërruar nenin ekzistues 5, pika 5.5 "...Komuna Partesh me seli në Partesh..." me tekstin e ri "...Komuna Partesh me seli në Pasjan...". Divizioni i Monitorimit thekson që Vendimi i Kuvendit të Komunës së Parteshit mund të bëhet i plotfuqishëm në momentin e aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (ashtu siç parashihet me nenin 4 të Ligjit për Kufijtë Administrativ).

● Konkluzione

1 Kuvendi i komunës së Prizrenit tanimë ka stabilizuar dinamiken e mbajtjes së mbledhjeve.

2 Janë miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve komunale dhe me interes të përgjithshëm.

3 Përveç Komunës së Mamushës, katër komunat tjera kanë mbajtur tubime publike me qytetarë.

4 Komuna e Suharekës ka lidhur marrëveshje për binjakëzimin e dy Komunave, atë të qytetit të Fellbahut të Republikës së Gjermanisë dhe të qytetit të Suharekës të Republikës së Kosovës.

5 Në komunën e Prizrenit është themeluar Komiteti për Barazi Gjinore dhe Komiteti Komunal i Banimit.

6 Komuna e Mamushës ka lidhur marrëveshje mirëkuptimi me UN-HABITAT-in, në lidhje me projektin e planin urbanistik, ky projekt do të përkrahet edhe nga Republika e Turqisë.

7 Selia e Komunës së Parteshit nuk përkon me dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Kufijtë Administrativ nr. 03/L-041.

8 Komuna e Parteshit ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

KOMUNAT: PRISHTINË, PODUJEVË, LIPJAN, FUSHË-KOSOVË

Mbledhjet e mbajtura

Gjatë kësaj periudhe janar-qershor të vitit 2011, Komunitat: Prishtinë, Lipjan, Podujevë dhe Fushë-Kosovë kanë mbajtur gjithsej 23 mbledhje. Këto Komuna kanë qenë brenda dinamikës së paraparë me LVL për mbajtjen e mbledhjeve. Në vijim kemi paraqitur numrin e mbledhjeve në formë grafike:




Fig. 22. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë-Kosovë

Nga ky pasqyrim rrjedh që Kuvendet e Komunave: Podujevë, Prishtinë dhe Fushë-Kosovë kanë mbajtur nga 6 mbledhje, ndërkohë që Lipjani ka mbajtur 5 mbledhje.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna, janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste kur subjektet politike kanë lëshuar mbledhjet ose nuk kanë marrë pjesë në punimet e kuvendit.

Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së, të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-ve të ndryshme, mjeteve të informimit si dhe qytetarëve të interesuar. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të Komunës është bërë përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së komunës.

Po ashtu, sa i përket transparencës duhet të përmendet se Komuna e Podujevës, informimin e qytetarëve e bënë edhe përmes shpalljeve në bashkësitë lokale.

Krahasuar me vitin 2010, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Podujevë, Fushë-Kosovë dhe Lipjan kanë mbajtur numër të përafërt të mbledhjeve.




Fig. 23. Krahasimi i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011

Komitetet e obligueshme, si trupa të kuvendit, gjatë kësaj periudhe kanë qenë funksionale.




Fig. 24. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komunat: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë-Kosovë

Sipas kësaj paraqitje, në Komunën e Prishtinës KPF ka mbajtur 6 mbledhje, kurse KK ka mbajtur 7 mbledhje, në Komunën e Podujevës KPF dhe KK kanë mbajtur nga 6 mbledhje, në atë të Lipjanit KPF ka mbajtur 6 mbledhje, kurse KK 4 mbledhje dhe në Komunën e Fushë Kosovës KPF ka mbajtur 5 mbledhje, kurse KK 6.

Komunat kanë mbajtur edhe tubime publike me qytetarë. Sipas të dhënave del që Komuna e Fushë-Kosovës është treguar më aktivja në këtë drejtim duke mbajtur gjithsej 4 tubime me qytetarë. Gjithashtu edhe Komuna e Lipjanit ka mbajtur 3 tubime që së bashku me Komunën e Fushë-Kosovës i bënë të dallohen nga komunat tjera për gatishmërinë që të

sjellin qytetarët sa më afër procesit vendimmarrës. Krahas tyre, tubime publike me ka mbajtur edhe Komuna e Prishtinës e cila ka organizuar një tubim, ndërkohë që Komuna e Podujevës nuk ka thirrur asnjë tubim me qytetarë.

Këto komuna, janë treguar mjaft aktive në nxjerrjen e akteve komunale. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar gjithsej 72 vendime dhe 5 rregullore. Në vijim janë paraqitur të dhënat për secilën komunë veç e veç:




Fig. 25. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë-Kosovë

Nga kjo shihet që nga aspekti kuantitativ më aktive ka qenë Komuna e Fushë Kosovës me gjithsej 31 vendime, pastaj Komuna e Prishtinës me 21 vendime dhe 1 rregullore, Lijani me 11 vendime dhe 1 rregullore, kurse Komuna e Podujevës me 9 vendime dhe 4 rregullore.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010, në vitin 2011 vërehet numër më i pakët i akteve të miratuara në Kuvend e sidomos rregulloreve komunale.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - Sipas të dhënave vetëm Komuna e Prishtinës ka mbajtur takime të KKS-së ashtu siç kërkohet me aktet ligjore në fuqi. Në vijim kemi elaboruar në formë grafike numrin e mbledhjeve të KKS-së në këto komuna:




Fig. 26. Numri i mbledhjeve të KKS-së në Komunat: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë-Kosovë

Në krahasim me vitin 2010, ku në Komunën e Prishtinës KKSB është mbledhur vetëm 1 herë, gjatë kësaj periudhe ky këshill ka qenë më funksional duke mbajtur gjithsej 4 takime, pra vërehet një aktivitet më i shtuar i KKSB-së.

Kurse të tri komunit tjerë kanë mbajtur numër të përafërt të mbledhjeve krahasuar me vitin paraprak. Pra siç shihet në grafikun e mësipërm, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 Komuna e Lipjanit ka mbajtur 4 takime të KKSB-së, Podujeva 2 takime, ndërkohë që Fushë-Kosova ka mbajtur vetëm një tubim.

Përmbledhje nga mbledhjet e kuvendit

PRISHTINA

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, gjatë kësaj periudhe janar-qershor ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Kuvendi ka qenë funksional dhe nuk është shënuar ndonjë lëshim sa i përket respektimin të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Nga aspekti normativ, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka miratuar 21 vendime dhe 1 rregullore. Në këtë drejtim, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka miratuar raportin financiar për vitin 2010. Lidhur me këtë raport, janë zhvilluar diskutime të shumta para miratimit, me ç'rast opozita ka qenë mjaft kërkuese në arsyetimin e çdo shpenzimi të bërë nga komuna.

Duke iu shmangur konfliktit të interesit, duhet cekur se në Komunën e Prishtinës gjatë këtij 6 mujori, ka dhënë dorëheqje Drejtoresha e Shëndetësisë, për arsye të zgjedhjes deputete në Parlamentin e Kosovës. Po ashtu, edhe njëri nga anëtarët e kuvendit, ka ofruar dorëheqjen, për arsye se është zgjedhur drejtor në një ndërmarrje publike.

Pozita të dyfishta gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar, ndërsa sa i përket konfliktit të interesit me rastin e vendimmarrjes nuk është shënuar asnjë rast. Këtu vlenë të përmendet se kryesuesi i Kuvendit, para shqyrtimit dhe votimit të një çështjeje, nuk ka pyetur në asnjë rast anëtarët e kuvendit nëse kanë konflikt interesi. Kjo edhe e vështirëson identifikimin e rasteve të tilla.

Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren për të Hyrat Vetanake të Institucioneve Arsimore. Në mesin e shumë vendimeve të miratuara me rëndësi, paraqet Vendimi mbi formimin e Komisionit për emërtim të rrugëve dhe vendeve të tjera publike, i miratuar në mbledhjen e 31 marsit 2011. Kuvendi ka miratuar gjithashtu vendimin për ndarjen e mjeteve në shumë prej 70.000 € për familjet e prekura gjatë vërshimeve të fundit në Komunën e Prishtinës.

Një vëmendje i është kushtuar edhe miratimit të disa raporteve të ndërmarrjeve publike, si dhe miratimit të Statuteve të ndryshme, si ai i Teatrit të Qytetit, të Qendrës së Mjekësisë Familjare, Arkivit të Komunës etj.

Sa i përket ligjshmërisë së akteve, gjatë kësaj periudhe në bazë të monitorimit të mbledhjeve, nuk është evidentuar ndonjë rast i shkeljeve ligjore.

Të gjeturat

- Në Komunën e Prishtinës mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë qenë të hapura për publikun që nga viti i 2010 deri në maj të vitit 2011. Në lidhje me këtë, janë evidente edhe reagimet e medieve të shkruara dhe shoqërisë civile për mospërfshirjen e tyre në mbledhjet e këtij Komiteti. Sipas kësaj rezultojnë që është bërë shkelje e legjislacionit në fuqi lidhur me transparencën e organeve komunale. Çështja në fjalë është e rregulluar me dispozitat ligjore dhe nënligjore, të paraqitura në vijim: Sipas nenit 45.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale "Takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion". Ndërkohë, me Udhëzimin Administrativ Nr.2008/03 për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 2006/03 "Për transparencën në Komunë", në nenin 3, paragrafi 1 thuhet "Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjen që është objekt diskutimi". Neni 5 i Rregullores për Transparencë të Komunës së Prishtinës thekson se "Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik"
- Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal më dt. 29.03.2011, ka pranuar ankesën nga një qyetatar i Komunës së Prishtinës, e që ka të bëjë me Rregulloren për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se Rregullorja për legalizimin e ndërtimeve pa leje e miratuar në vitin 2008, është në kundërshtim me dispozitat ligjore nga sfera e ndërtimit dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. MAPL me këtë rast, ankesën në fjalë e ka adresuar për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Edhe pse me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komuna obligohet që t'i paraqes organit mbikëqyrës aktet e miratuara për vlerësim të ligjshmërisë, kjo komunë deri më tani nuk ka përmbushur këtë obligim ligjor.

PODUJEVA

Kuvendi i Komunës së Podujevës, gjatë kësaj periudhe ka qenë funksional dhe ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje debatet kanë qenë konstruktive dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit është respektuar me përpikmëri.

Deri më tani në këtë Komunë nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit në vendimarrje, e po ashtu nuk është paraqitur ndonjë rast i pozitive të dyfishta të anëtarëve të kuvendit. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar gjithsej 9 vendime dhe 4 rregullore. Një ndër vendimet më të rëndësishme të miratuara gjatë kësaj periudhe, është Vendimi për mënyrën e përdorimit të Emblems së Komunës së Podujevës. Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar Planin Zhvillimor Urban, duke marrë për bazë se Komuna e Podujevës nuk ka pasur më parë një plan të tillë. Ndërsa sa i përket

Rregulloreve, janë miratuar:

- 1) Rregullorja për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës së komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit të Komunës së Podujevës;
- 2) Rregullorja për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes;
- 3) Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve;
- 4) Rregullorja për transport në territorin e Komunës së Podujevës;

Gjatë këtij gjashtëmujori, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e shpenzimeve për vitin 2010, në të cilin janë paraqitur në mënyrë të qartë të gjitha shpenzimet e Komunës.

Komuna e Podujevës, ka qenë e përgjegjshme sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë. Të gjitha aktet e miratuara i janë dërguar organit mbikëqyrës për shqyrtim administrativ, ashtu siç parashihet me LVL. Deri më tani nuk është evidentuar asnjë shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve.

Të gjeturat

- Sa i përket të gjeturave në këtë komunë nuk është evidentuar asnjë rast i shkeljeve ligjore.

LIPJAN

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta. Deri tani nuk është evidentuar asnjë rast i konfliktit të interesit me rastin e marrjes së vendimeve. Përderisa në vitin 2010 kemi shënuar raste të mbajtjes së pozitave të dyfishta, në vitin 2011 janë evituar rastet e tilla.⁹

Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe, ka miratuar 11 vendime dhe 1 rregullore.

Ndër aktet me rëndësi është Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e panelit përzgjedhës për intervistimin e kandidatëve të paraqitur sipas konkursit për formimin e Komitetit Konsultativ të Shërbimeve Publike. Po ashtu është nxjerrë vendimi për emërimin e Këshillit të ekspertëve të planifikimit, me të cilin vendim këshilli në fjalë ka për obligim këshillimin profesional gjatë procesit të hartimit të planeve zhvillimore komunale.

Kjo komunë ka miratuar Kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2012-2014, me të cilën përveç granteve të alokuara nga niveli qendrorë, komuna ka paraparë edhe rritjen e të hyrave vetanake. Gjatë kësaj periudhe është miratuar edhe Plani Komunal për Mbrojtje nga Zjarri, Rregullorja për caktimin e kushteve dhe kriterëve për dhënie me qira të banesave në pronësi të Komunës, e të tjera.

Të gjeturat

- Në Komunën e Lipjanit sikurse në vitin 2010, edhe për kundër ndalesës së pagës së njërit nënkryetarë të Komunës, në bazë të Udhëzimit Administrativ të nxjerrur nga MAP dhe MAPL, i njëjti vazhdon ende të mbaj këtë pozitë.

⁹ Shih raportin mbi funksionimin e Komunave për vitin 2010

- Numri i drejtorive në këtë Komunë nuk është në përputhje me Statutin e Komunës me të cilin parashihet që t'i ketë 10 drejtori. Ndërsa aktualisht funksionojnë 13 drejtori. Ministria e Administrimit të Pushtet Lokal, në vitin e kaluar ka dërguar, shkresën në komunë, në të cilën ka kërkuar nga kryetari, që të rishqyrtoj vendimin për rritjen e numrit të drejtorive. Deri më tani kjo komunë nuk ka ndërmarr asnjë veprim për implementimin e rekomandimeve të MAPL-së.
- Komuna e Lipjanit nuk i dërgon aktet e miratuara në Kuvend për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës.

● Konkluzione

1 Komuna e Podujevës dhe Fushë-Kosovës, dërgojnë aktet për vlerësim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës me rregull, ndërkohë që Komuna e Prishtinës dhe e Lipjanit nuk zbatojnë detyrimet ligjore në këtë drejtim.

2 Në Komunën e Prishtinës, Komiteti për Politikë dhe Financa në vitin 2011 është hapur për publikun.

3 Në Komunën e Lipjanit, ende vazhdojnë të mbajnë pozitën dy nënkryetar nga komuniteti shumicë.

4 Komuna e Podujevës ka miratuar Planin Zhvillimor Urban.

5 Komuna e Lipjanit ka miratuar Planin për Mbrojtje nga Zjarri. Në komunën e Lipjanit numri i drejtorive nuk korrespondon me numrin e paraparë në Statutin e saj.

KOMUNAT: PEJË, KLINË, ISTOG, MALISHEVË

Mbledhjet e mbajtura

Sipas nenit 43.2 të LVL-së, Kuvendi i Komunës, mbanë së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit. Në bazë të raportit kemi konstatuar se Komunitat: Pejë, Klinë, Istog dhe Malishevë kanë mbajtur numrin e mbledhjeve në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendet e Komunave: Pejë, Istog, Klinë dhe Malishevë gjatë periudhës janar – qershor 2011 kanë mbajtur gjithsej 23 mbledhje të rregullta, të paraqitura në formë grafike si në vijim:




Fig. 27. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Pejë, Istog, Klinë, Malishevë





Fig.28. Krahasoni i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011

Siç shihet nga ta tabela e mësipërme, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, numri i mbledhjeve të kuvendeve të këtyre komunave në vitin 2011 është pothuajse i njëjtë, për vetëm një mbledhje më pak.

Komunat e lartcekura në përgjithësi kanë dërguar me kohë ftesën dhe materialin për mbledhje, por ka pasur edhe rastet kur materialet kanë arritur me vonësë.

Krahas kësaj, në këto komuna kanë funksionuar edhe Komitetet obligative. Përderisa Komiteti për Komunitete në Komunën e Malishevës nuk ka qenë funksional deri në mars të vitit 2011, në tremujorin e dytë të vitit 2011 ky komitet është funksionalizuar duke mbajtur një mbledhje. Në vijim kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të komiteve obligative:



Nga ky grafik shihet që në Komunën e Malishevës KPF ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur 1 mbledhje, në Komunën e Pejës KPF ka mbajtur 5 mbledhje kurse KK 6, në Klinë KPF ka mbajtur 7 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 6 dhe në Komunën e Istogut, KPF dhe KK kanë mbajtur nga 6 mbledhje.

Fig. 29. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komuna: Pejë, Istog, Klinë, Malishevë

Kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar vendime me rëndësi dhe me interes për qytetarët, por që nuk duhet përfshirë edhe evidentimin e shkeljeve ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Në vijim kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e këtyre komunave:

Nga figura e paraqitur rrjedh që Kuvendi i Komunës së Pejës ka miratuar 35 vendime dhe 1 rregullore, Istogu ka miratuar 16 vendime dhe 3 rregullore, Klinë ka miratuar 29 vendime dhe Malisheva ka miratuar 15 vendime dhe 1





Fig.30. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Pejë, Istog, Klinë, Malishevë

rregullore. Në total numri i akteve të miratuara në këto komuna është 100 dhe nëse krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2010 del që numri të jetë më i vogël.

Sa u përket tubimeve publike me qytetarë, Komuna e Malishevës, ka thirrur një tubim të tillë, mirëpo si rezultat i pjesëmarrjes shumë të ulët të qytetarëve, tubimi është shtyrë për në muajin korrik. Gjithashtu, Komuna e Pejës dhe Istogut nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë. Prej tyre, vetëm Komuna e Klinës, ka organizuar 1 takim publik me qytetarë

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi – KKSB në të katër komunat ka qenë aktive në mbajtjen e mbledhjeve.



Sipas grafikut të mësipërm, KKSB në Komunën e Pejës ka mbajtur 4 mbledhje, në Komunën e Klinës ka mbajtur 4 mbledhje, në Istog ka mbajtur 5 mbledhje, ndërsa në komunën e Malishevës ka mbajtur 6 mbledhje.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

MALISHEVË

Gjatë periudhës janar-qershor 2011, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka funksionuar normalisht. Ftesat për mbledhje janë dërguar në Ministri konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë periudhë të raportimit, Kuvendi i Komunës ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Prej mbledhjeve të mbajtura në këtë gjashtëmujor është evidentuar një rast i lëshimit të mbledhjes së Kuvendit nga ana e anëtarëve të opozitës, për shkak të mospajtimeve të caktuara gjatë miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Projekt-Rregullores për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2011.

Duhet shtuar që në këtë komunë, opozita ka qenë shumë aktive gjatë zhvillimeve të punimeve në kuvend, duke dhënë vërejtje konstruktive gjatë procesit të shqyrtimit dhe miratimit të akteve.

Në periudhën janar-qershor 2011, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar 15 vendime dhe 1 rregullore.

Gjatë monitorimit janë evidentuar dy raste të shkeljeve ligjore. Kështu, në muajin mars, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka bërë shkelje ligjore me rastin e marrjes së Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës publike komunale, për qëllim të ndërtimit të minifabrikës për ndërtimin e konstruksioneve metalike. Ky vendim vlerësohej të ishte i kundërligjshëm pasi që, posedues i pronës së kërkuar është OTHPB Ekonomia e Pyjeve, dhe vendimi i marrë është pa pëlqimin e Ekonomisë së Pyjeve dhe AKP-së.

Po ashtu është evidentuar shkelje e procedurave ligjore në miratimin e Rregullores për Organizimin e zgjedhjeve nëpër vendbanime dhe fshatra të Komunës së Malishevës. Rregullorja në fjalë ishte miratuar, pa kaluar në diskutim publik. Prandaj konsiderohej se ka pasur shkelje të Statutit të Komunës respektivisht nenit 12. Kjo rregullore është dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në Departamentin Ligjor të MAPL-së.

Kur jemi tek aktet komunale, vlen të potencohet fakti se, Komuna e Malishevës edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, nuk ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve, gjë që bie në kundërshtim me nenin 9.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë kësaj periudhe është bërë zëvendësimi i një anëtare të kuvendit për shkak të zgjedhjes së saj deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket pozitive të dyfishta, ende janë dy raste të mbajtjes së pozitive të dyfishta nga anëtarët e kuvendit.¹⁰

Prej gjithsej 16 akteve të miratuara në këtë gjashtëmujor, vlen të përmendet:

1) Vendimi për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë

¹⁰Shih Raportin e monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës për vitin 2010, fq. 49

tjera në Komunën e Malishevës.

- 2) Vendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Projekt-Rregullores për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoba Komunale – 2011.
- 3) Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve nëpër vendbanime dhe fshatra të Komunës së Malishevës.
- 4) Vendimi për bartjen e mjeteve nga buxheti i vitit 2010 në buxhetin e vitit 2011.
- 5) Vendimi për miratimin e projekt-rregullores për organizimin e zgjedhjeve nëpër vendbanime dhe fshatra të Komunës së Malishevës.
- 6) Rregullore për organizimin e zgjedhjeve nëpër vendbanime dhe fshatra të Komunës së Malishevës.

Të gjeturat

- Gjatë periudhës së raportimit në Komunën e Malishevës është evidentuar një rast i lëshimit të mbledhjes së Kuvendit nga ana e anëtarëve të opozitës, me rastin e miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Projekt-Rregullores për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoba Komunale – 2011.
- Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë evidentuar dy raste të shkeljeve ligjore.
- Edhe gjatë kësaj periudhe, Komuna e Malishevës nuk ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.

PEJË

Edhe Komuna e Pejës gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti, ka funksionuar normalisht. Komuna ftesën për mbledhje e ka dërguar konform dispozitave të LVL-së. Gjatë kësaj kohe Kuvendi i Komunës ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta, në të cilat mbledhje janë miratuar gjithsej 35 vendime dhe 1 rregullore.

Ajo që vlen të potencohet te kjo Komunë është fakti se, në vazhdimësi në mbledhjet e Kuvendit të Komunës kanë qenë evidente rastet e këmbimit të pronave private me ato komunale, rastet e dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore që janë nën menaxhimin e AKP-së duke bërë kështu shkelje ligjore. Rastet e evidentuara si shkelje janë proceduar për shqyrtim në Departamentin Ligjor të MAPL-së.

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente për publikun. Koha e mbajtjes së mbledhjeve është publikuar në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen e komunës dhe në mediet lokale. Edhe në këtë komunë, roli i opozitës ka qenë shumë konstruktiv.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Pejës ka miratuar 35 vendime dhe 1

rregullore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i akteve të miratuara gjatë këtij viti është më i madh.

Edhe në këtë komunë ka pasur lëvizje të anëtarëve të kuvendit. Kështu, anëtari i kuvendit z. Gazmend Agusholli, meqenëse ishte zgjedhur Drejtor i Qendrës së Mjekësisë Familjare, kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit, dhe në vend të tij kishte ardhur z.Mentor Bajri.

Në Komunën e Pejës, njëri nga anëtarët e kuvendit, i cili ka mbajtur edhe pozitën e drejtorit të shkollës fillore, tanime ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit duke vazhduar në pozitën e anëtarit të kuvendit. Kjo e bënë që në Komunën e Pejës, të mos ketë më raste të mbajtjes së pozitave të dyfishta.

Në kuadër të aktivitetit të saj, Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë kësaj periudhe ka miratuar 35 vendime dhe 1 rregullore. Disa nga vendimet e miratuara janë:

- 1) Vendimi për hedhjen në diskutim publik të Draft Rregullores për Shërbime Publike Komunale në Komunën e Pejës.
- 2) Vendimi për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt-Planit Rregullues Urban të B.T."Kristali".
- 3) Vendimi për miratimin e Rregullores për Shërbimet Publike Komunale.
- 4) Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale.
- 5) Vendimi për emërimin e Komisionit për hartimin e Planit Komunal të veprimit, për implementimin e synimeve të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë, për periudhën afatgjatë 2011-2016.
- 6) Vendimi për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të projekt-rregullores për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2011.
- 7) Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm shoqëror, dhënia në shfrytëzim e hapësirës ngast.kad.nr.3019 pronë shoqërore në sipërfaqe prej 01.97,20 ha, Shkollës së Mesme "Ali Hadri" për investime ndërtimore në profilet e bujqësisë me qëllim të realizimit të donacionit të përfituar nga Organizata Qeveritare "Danida" nga Danimarka.
- 8) Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm shoqëror dhe shpronësimi i ngast.kad.nr.4309/237 në sipërfaqe prej 80 m2, pronë e znj.Rabije Muriqi, nga Peja, për zgjerimin e rrugës publike në lagjen Fidanishte Pejë.
- 9) Vendimi për dhënien e një pjese të pronës komunale me kompensim në sipërfaqe prej 5,90m2 në Çarshi të Gjatë, bashkëpronarëve z.Ejyp dhe Bujar Kastrati nga Peja, për formim të tërësisë ndërtimore sipas Projektit të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore Historike Pejë.
- 10) Vendim për shpalljen qytetar nderi i qytetit të Pejës, ish Kryeadministratorin e Kosovës z. Soren Jesen Petersen.

Të gjeturat

- Kuvendi i Komunës së Pejës, në mbledhjen e mbajtur në muajin mars ka marrë Vendim që patundshmëria e ish-Koperativave Bujqësore të cilat gjenden në territorin e Komunës së Pejës, të regjistrohen si pasuri shoqërore në emër të Kuvendit të Komunës së Pejës, gjë që bie ndesh me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.03/L-067, dhe me Ligjin për dhënien në shfrytëzim

dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226. MAPL duke u bazuar në nenin 81.4 të LVL-së, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij Vendimi, ka vlerësuar se është në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.03/L-067, dhe me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226. Për këtë rast të evidentimit të shkeljes Ligjore, MAPL ka dërguar shkresë në komunë me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit në fjalë. Komuna në lidhje me këtë çështje deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

- Po ashtu, në muajin mars është marrë edhe Vendimi për këmbimin e pronës shoqërore të ish Kombinatit të Drurit në Pejë me pronën private të z.Hamdi Morina, Vendim i cili konsiderohej të ishte në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.03/L-067 dhe me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226. Ndërkohë që edhe për këtë çështje nga Kuvendi i Komunës, është kërkuar rishqyrtimi i këtij Vendimi.
- Në vazhdimësi janë evidentuar edhe raste tjera të shkeljeve ligjore në këtë komunë, të cilat janë proceduar në Departament Ligjor për shqyrtim të Ligjshmërisë.
- Është vërejtur një përqendrim i Kuvendit të Komunës në çështjet e ndërrimit të pronës private me pronë komunale, si dhe rastet e dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore që janë nën menaxhimin e AKP-së.
- Komuna e Pejës gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetarët.

KLINË

Komuna e Klinës në gjashtë mujorin e parë të vitit 2011 ka funksionuar normalisht dhe ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Nga kjo mund të shihet se Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur numrin e mbledhjeve në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente për publikun. Koha e mbajtjes së mbledhjeve është publikuar në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen e komunës dhe në radiot lokale.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar-qershor 2011, Komuna e Klinës ka organizuar një takim publik me qytetarët.

Në këtë periudhë kohore, Kuvendi i Komunës së Klinës ka miratuar 29 vendime. Prej vendimeve të miratuara, gjatë monitorimi është evidentuar një rast i shkeljes ligjore. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar numri i akteve të miratuara në këtë Komunë për periudhën janar-qershor të këtij viti është më i madh.

Në periudhën janar-qershor, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit.

Aktet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1) Vendimi për riemërtimin dhe organizimin e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Klinës, konform Statutit të Komunës, dhe organogramit të Komunës.
- 2) Vendimi për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga të hyrat në vitin 2010.

- 3) Vendimi për miratimin e Planit të Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2011.
- 4) Vendimi për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit.
- 5) Vendimi për miratimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2010.
- 6) Vendim për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së punës së Kuvendit dhe Komiteteve.
- 7) Vendim për hartimin e Projekt-Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Komunës dhe formimin e Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores.
- 8) Vendimi për formimin e Këshillit të ekspertëve të Planifikimit.
- 9) Vendimi për themelimin e Komisionit të veçantë për vlerësimin e ofertave dhe propozimin e listës së ngushtë Kuvendit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.
- 10) Vendimi për lejimin e lokacionit për varreza të fshatit Siqevë.
- 11) Vendimi mbi vënien në diskutim publik të Projekt-Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Komunës.

Të gjeturat

- Në muajin prill, Kuvendi i Komunës së Klinës ka bërë shkelje ligjore me rastin e marrjes së Vendimit për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore të Kuvendit të Komunës së Klinës për 7 (shtatë) familje për të kthyerit RAE. Ky vendim bie në kundërshtim me nenin 5 pika 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.03/L226, i cili përcakton qartazi kohën e dhënies në shfrytëzim të pronave, ndërkohë që me këtë vendim nuk është parapa afati i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të Kuvendit të Komunës.
- MAPL ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit në fjalë.
- Në Komunën e Klinës ka ndërruar jetë një anëtar i Kuvendit, ndërkohë që deri më tani nuk është bërë zëvendësimi me një anëtar të ri.

ISTOG

Edhe Kuvendi i Komunës së Istogut, gjatë periudhës janar-qershor 2011 ka funksionuar normalisht. Ftesa dhe materiali për mbledhje të kuvendit është dërguar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë periudhë të raportimit, kuvendi i kësaj komune ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Në këtë komunë gjatë kësaj periudhë të raportimit, nuk është evidentuar ndonjë rast bojkoti të mbledhjes nga ana e opozitës.

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente për publikun. Koha e mbajtjes së mbledhjeve është publikuar rregullisht në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen e komunës, ndërkohë që në to kanë qenë pjesëmarrës, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, Medieve si dhe qytetarët e interesuar.

Kuvendi i Komunës së Istogut në periudhën janar-qershor 2011, ka miratuar 16 vendime dhe 3

rregullore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i akteve të miratuara në këtë komunë për periudhën janar-qershor është më i vogël. Gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, qoftë tek ushtrimi i pozitave të dyfishta apo tek marrja e vendimeve. Aktet më të rëndësishme të cilat janë marrë gjatë kësaj periudhe janë:

- 1) Vendimi për ndarjen dhe themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale.
- 2) Vendimi për hedhjen në diskutim publik për projekt-rregulloren mbi dhënien e tokës komunale dhe lokaleve në shfrytëzim të përkohshëm.
- 3) Vendimi për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2011.
- 4) Vendimi për shpalljen në diskutim publik të Planit Rregullativ Urban për Guragoc.
- 5) Vendimi për shpalljen në diskutim publik të Planit Zhvillimor Urban për Saradran.
- 6) Vendimi për hedhjen në diskutim publik të projekt – rregullore për reklamimin, shitjen e mallrave dhe artikujve tjerë jashtë lokaleve afariste.
- 7) Vendimi për hedhjen në diskutim publik të projekt – rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në komunën e Istogut.
- 8) Rregullorja mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme komunale.
- 9) Rregullorja për shërbimet publike komunale grumbullimin, bartjen, deponimin dhe përpunimin e mbeturinave në territorin e komunës së Istogut.
- 10) Rregullore për dhënien e lejes së punës subjekteve afariste në Komunën e Istogut.

Të gjeturat

- Komuna e Istogut gjatë kësaj periudhe nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetarët.

Konkluzione

- 1** Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2011, janë evidentuar si dhe raportuar tre raste të shkeljeve ligjore në Komunën e Pejës, dy në Komunën e Malishevës dhe një në Klinë.
- 2** Në Komunën e Malishevës është funksionalizuar Komiteti për Komunitete.
- 3** Me përjashtim të Komunës së Klinës e cila ka mbajtur gjatë kësaj periudhe një takim publik me qytetarë, Komuna e Pejës, Istogut dhe Malishevës nuk kanë mbajtur asnjë tubim të tillë.
- 4** Në Komunën e Malishevës është evidentuar një rast i lëshimit të mbledhjes nga ana e subjektit politik të LDK-së (subjekt opozitar në këtë Komunë).

- 5** Në Komunën e Klinës ende nuk është bërë zëvendësimi i anëtares së Kuvendit e cila ka ndërruar jetë.
- 6** Në Kuvendin e Komunës së Pejës janë shënuar raste të dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore që janë nën menaxhimin e AKP-së.
- 7** Komuna e Malishevës edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka miratuar Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.
- 8** Në Komunën e Pejës, njëri nga anëtarët e kuvendit, i cili ka mbajtur edhe pozitën e drejtorit të shkollës fillore, tanimë ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit duke vazhduar në pozitën e anëtarit të kuvendit.

KOMUNAT: VITI, OBILIQ, HANI I ELEZIT DHE KLLOKOT

Mbledhjet e mbajtura

Kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme si dhe takime publike me qytetarë. Në bazë të monitorimit të rregullt të kuvendeve të komunave rezulton se komunat kanë mbajtur numër të mjaftueshëm të mbledhjeve në këtë gjashtëmuor.

Nga kjo del se janë mbajtur gjithsejtë 27 mbledhje, prej tyre 23 të rregullta dhe 4 mbledhje e jashtëzakonshme.

Ftesat dhe materialet për mbledhje nga këto komuna, janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste që ndonjë subjekt të mos merr pjesë në punën e kuvendit.

Rrjedha e punës së Kuvendeve të Komunave është shoqëruar me diskutime konstruktive, si nga opozita por edhe pozita.

Në vitin 2010 këto komuna kanë mbajtur gjithsej 17 mbledhje. Në vijim është paraqitur në formë tabelore krahasimin i numrit të mbledhjeve me vitin paraprak:




Fig. 32 Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit dhe Klllokot.




Fig. 34. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit dhe Klllokot.

Nga të dhënat të cilat i posedojmë del se në vitin 2011 janë mbajtur më shumë mbledhje.




Fig. 34. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komunat: Viti, Obiliq, Hani i Elezit dhe Klllokot.

Në kuadër të obligimeve që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendet e Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit dhe Klllokot, i kanë funksionale Komitetet e Obligueshme.

Në Komunën e Klllokotit, KPF ka mbajtur 8 mbledhje, ndërsa KK ka mbajtur 6, në Hanin e Elezit KPF ka mbajtur 6 mbledhje, kurse KK ka mbajtur 3 mbledhje, në atë të Obiliqit KPF ka mbajtur 7 mbledhje ndërsa KK ka mbajtur vetëm 1 mbledhje, kurse në Komunën e Vitisë KPF ka mbajtur 4 mbledhje dhe KK ka mbajtur 1.

Duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, del se në vitin 2011 KPF dhe KK janë më efikase në mbajtjen e mbledhjeve.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, në Komunën e Vitisë nuk është mbajtur asnjë takim publik me qytetarë. Në Komunën e Obiliqit është mbajtur 1 takim publik me qytetarë ndërsa në Komunën e Klllokotit dhe Hanit të Elezit janë mbajtur nga 2 takime.





Fig. 35. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Viti, Obiliq, Hani i Elezit dhe Klllokot.

Në tërësi, Kuvendet e këtyre Komunave kanë miratuar gjithsejtë 96 akte juridike. Prej tyre janë nxjerrë 84 vendime dhe 12 rregullore.

Komuna që kryeson me numrin më të madh të akteve të miratuara është Obiliqi, e cila gjatë periudhës raportuese ka miratuar 36 vendime dhe 2 rregullore. Pastaj vjen Komuna e Hanit të Elezit me 27 vendime dhe 4 rregullore, Komuna e Vitisë me 15 vendime dhe 2 rregullore. Komuna që më pak ka miratuar akte juridike është ajo e Klllokotit e cila ka miratuar 6 vendime dhe 4 rregullore. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010 ekziston numër i përafërt i miratimit të akteve në vitin 2011.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi – Numri i mbledhjeve të KKSBS-së në këto komuna lëviz nga njëra komunë në tjetrën. Përderisa Komuna e Vitisë dhe Obiliqit nuk kanë mbajtur asnjë takim të KKSBS-së, Komuna e Hanit të Elezit dhe Klllokotit janë kujdesur në këtë drejtim.



Përderisa Komuna e Vitisë në vitin 2010 kishte mbajtur gjithsej 5 mbledhje, në vitin 2011 gjendja tregon që kjo komunë ka qenë shumë pasive në këtë drejtim. I njëjti konstatim vlenë edhe për Komunën e Obiliqit.

Krahas tyre Komuna e Hanit të Elezit ka mbajtur 3 takime kurse më aktivja në këtë drejtim ka qenë Komuna e Klllokotit e cila ka mbajtur gjithsej 6 takime.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

VITIA

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, po ashtu ka miratuar 15 vendime dhe 2 rregullore. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-të e ndryshme, mjetet e informimit si dhe qytetarët e interesuar.

Kjo periudhë gjashtë mujore e Kuvendit të Komunës së Vitisë ka pasur sfida të ndryshme në rrafshin normativ. Zakonisht kur kemi të bëjmë me miratimin e akteve konkretisht të vendimeve, anëtarët e kuvendit zgjojnë interesimin dhe debatojnë gjatë shqyrtimit të tyre.

Kuvendi i kësaj komune ka miratuar vendime me rëndësi dhe me interes për qytetarët, por që nuk duhet përjashtuar edhe parregullsitë gjatë marrjes së vendimeve.

Duhet vlerësuar rolin e opozitës është shumë konstruktive në debate dhe luan rol shumë të

rëndësishëm në mbarëvajtjen e mbledhjes, duke i bërë gjithashtu të reagojnë me rastin e nxjerrjes vendimeve të pretenduara si të kundërligjshme.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të komunës është bërë përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes komunale.

Në përgjithësi, Komuna e Vitisë ka respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve për mbledhjet, të cilat në shumicën e rasteve kanë filluar dhe janë zhvilluar në përputhje me rendin e ditës. Kuorumi në të gjitha këto mbledhje ka qenë i mjaftueshëm.

Gjithashtu, kuvendi ka nxjerr edhe disa vendime me rëndësi të cilat kanë pasur rëndësi për Komunën e Vitisë.

Një nga vendimet me rëndësi të veçantë ka qenë Vendimi për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të Statutit të Komunës së Vitisë. Pastaj, kemi edhe Vendimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake. Komuna e Vitisë është përkujdesur që të jetë transparente ndaj qytetarëve për aktivitetet e saj. Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Kjo iu ka mundësuar qytetarëve informim të duhur lidhur me punën e kuvendit të komunës.

Vlen të theksohet se drejtori i administratës së Komunës ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit meqenëse është emëruar Zv/Ministër në Ministrinë e Drejtësisë.

Të gjeturat

- Në komunën e Vitisë edhe pse pozita e zëvendëskryesuesit të Kuvendit për Komunitete është e rezervuar për komunitetin pakicë, ajo aktualisht vazhdon të mbahet nga pjesëtari i komunitetit shumicë. Në këtë rast kemi shkelje të dispozitave të nenit 54 të LVL-së.
- Në mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2011 në Kuvendin e Komunës së Vitisë është marrë vendim për dhënien në shfrytëzim të lokalit afarist në ngastrën kadastrale Nr 3061. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë i jep në shfrytëzim të përhershëm veteranit dhe invalidit të luftës z. Xhavit Hasanit lokalin afarist në ngastrën Nr 3061 me sipërfaqe prej 158 m² dhe në vendin e quajtur "Komuna" e evidentuar në certifikatën Nr P-70101007-03061-0 ZK –Viti, pronë e Komunës së Vitisë. Me këtë rast kemi shkelje të dispozitave të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 03/L-226.
- Në mbledhjen e mbajtur me datën 20.04.2011 në Kuvendin e Komunës së Vitisë është marrë vendim për miratimin e Propozim-Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të Statutit të Komunës së Vitisë. MAPL ka vlerësuar se Statuti në fjalë është i kundërligjshëm në shumë pika dhe ka kërkuar rishqyrtimin e tij.

OBILIQ

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme dhe ka miratuar 36 vendime dhe 2 rregullore. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave, OJQ-të e ndryshme, mjetet e informimit si dhe qytetarët e interesuar. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të komunës bëhet përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së komunës. Në përgjithësi, Komuna e Obiliqit ka respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve për mbledhjet, të cilat në shumicën e rasteve kanë filluar dhe janë zhvilluar në përputhje me rendin e ditës. Kuorumi në të gjitha këto mbledhje ka qenë i mjaftueshëm.

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur 1 mbledhje të jashtëzakonshme, ku pika e rendit të ditës ka qenë "Furnizimi i dobët me energji elektrike". Kjo çështje është cilësuar si mjaft serioze dhe e rëndësishme duke e marrë parasysh faktin se mbi 80% e popullatës e paguajnë energjinë elektrike dhe nuk furnizohen me rrymë. Për rregullimin e kësaj çështje kanë kontribuar të gjithë faktorët me ndikim në komunë duke filluar nga këshilltarët komunal, kryesuesi i kuvendit dhe kryetari i komunës.

Kjo periudhë gjashtë mujore në Kuvendin e Komunës së Obiliqit ka pasur disa faza të funksionimit të cilat kishin të bëjnë me miratimin e akteve, konkretisht të vendimet e rëndësishme të cilat kanë zgjuar interesim dhe debat nga anëtarët e kuvendit gjatë shqyrtimit të tyre.

Kuvendi i kësaj komune ka miratuar vendime me rëndësi dhe me interes për qytetarët, por që nuk duhet përjashtuar edhe parregullsitë gjatë marrjes së vendimeve.

Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve në Kuvendin e Komunës së Obiliqit duhet theksuar se gjatë mbajtjeve të mbledhjeve nuk është respektuar me përpikëri Rregullorja e Punës së Kuvendit. Me këtë rast kuvendarët marrin fjalën pa rend, duke pretenduar në paaftësinë e kryesuesit të kuvendit për të udhëhequr me Kuvendin.

Në Komunën e Obiliqit, duhet theksuar se Komiteti për Politikë dhe Financa nga 9 anëtarë sa ka pasur, tani është zgjeruar edhe me 2 anëtarë të tjerë, pra ka gjithsej 11 anëtarë. Kjo nënkupton që çdo vendim i miratuar në mbledhje të KPF-së, të jetë vendim i miratuar edhe në kuvend, duke marrë parasysh se kuvendi ka 21 anëtar. Kjo kuptohet vetvetiu ngase KPF në përbërje ka gjysmën e anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i propozimeve që dalin në Kuvend nuk paraqet problem për votim.

Në Komunën e Obiliqit, ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim Vendimin mbi propozimin e anëtarëve të Komisionit për rishqyrtimin e kontratave mbi dhënien e pronave komunale në shfrytëzim që nga viti 99 e deri më tani. Krahas kësaj kemi edhe Vendimin mbi kërkesën nga Kryetari i Komunës për iniciativën për ndryshimin e Statutit të komunës, me të cilin inicohet procedura për ndryshimin e Statutit.

Komuna e Obiliqit është përkujdesur që të jetë transparente ndaj qytetarëve për aktivitetet e saj. Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Kjo ju ka

mundësuar qytetarëve informim të duhur lidhur me punën e Kuvendit të Komunës. Qytetarët e kësaj komune lidhur me aktivitetet komunale janë informuar përmes shpalljeve publike si dhe fletushkave të ndryshme. Në këtë komunë është funksionale ueb faqja zyrtare, por që aktet komunale nuk publikohen.

Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur ndonjë rast i cili ka të bëjë me konfliktin e interesit ose me pozitat e dyfishta.

Të gjeturat

- Në Kuvendin e Komunës së Obiliqit nuk është respektua Rregullorja e Punës së Kuvendit. Kuvendarët marrin fjalën pa leje parapara të kryesuesit të kuvendit.

HANI I ELEZIT

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Po ashtu, ka miratuar 27 vendime dhe 4 rregullore.

Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Hanit të Elezit është bërë shkarkimi i Drejtorit të Urbanizmit Z. Nexhmedin Daci dhe në vend të tij është emëruar z. Meqail Vila.

Gjithashtu në Komunën e Hanit të Elezit janë formuar dhe funksionalizuar edhe dy drejtori: Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Opozita është shumë konstruktive në debate dhe luan rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e mbledhjes. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë transparente për publikun.

Informimi i qytetarëve për mbledhje apo ndonjë aktivitet të komunës është bërë përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së komunës. Në përgjithësi, Komuna e Hanit të Elezit ka respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve për mbledhjet, të cilat në shumicën e rasteve kanë filluar dhe janë zhvilluar në përputhje me rendin e ditës.

Kuorumi në të gjitha këto mbledhje ka qenë i mjaftueshëm, me përjashtim të një rasti kur gjatë mbledhjes është ndërprerë mbledhja e kuvendit në mungesë të kuorumit për arsye të lëshimit të mbledhjes nga një pjesë e anëtarëve të kuvendit.

Ndër vendimet e miratuara në kuvend është Vendimi për ngritjen e padisë kundër Agjencionit Kosovar të Privatizimit për shkak të shitjes së Fabrikës për prodhimin e çimentos „Sharrcem”, Vendimi mbi formimin e Komisionit për grumbullimin e të dhënave dhe përgatitjen e padisë kundër Serbisë për krimet e kryera në territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Komuna e Hanit të Elezit është përkujdesur që të jenë transparente ndaj qytetarëve për aktivitetet e saj. Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Në këtë komuna është funksionale ueb faqja zyrtare.

Deri tani, nuk ka pasur ndonjë rast të konfliktit të interesit ose mbajtje të pozitave të dyfishta.

Të gjeturat

- Në Komunën e Hanit të Elezit me datën 30.06.2011 është shkëlja ligjore me rastin e nxjerrjes së Vendimit për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale për Mirëmbajtjen e Pastërtisë .

KLLOKOT

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i komunës së Kllokotit ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Po ashtu ka miratuar 6 vendime dhe 4 rregullore.

Në përgjithësi, Komuna e Kllokotit ka respektuar procedurat dhe afatet e njoftimeve për mbledhjet, të cilat në shumicën e rasteve kanë filluar dhe janë zhvilluar në përputhje me rendin e ditës. Kuorumi në të gjitha këto mbledhje ka qenë i mjaftueshëm.

Gjatë kësaj periudhë, kryetari i komunës ka emëruar nënkryetarin e komunës. Përveç kësaj, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren për Transparencë. Në kuadër të transparencës, Komuna është përkujdesur që të jetë e hapur ndaj qytetarëve për të gjitha aktivitetet e saj. Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Kjo ju ka mundësuar qytetarëve informim të duhur lidhur me punën e kuvendit të komunës. Në këtë komunë është funksionale edhe ueb faqja zyrtare.

Ndërkohë, që nuk ka pasur ndonjë rast i cili ka të bëjë me konfliktin e interesit ose me pozitat e dyfishta në Komunën e Kllokotit.

Të gjeturat

- Në Komunën e Kllokotit është paraqitur një peticion nga qytetarët me kërkesë për shkarkimin e kryetarit të Komunës. Peticioni në fjalë nuk është shqyrtuar në Kuvend për shkak të parregullsive në evidentimin e personave të cilët kanë nënshkruar atë.

KOMUNAT: MITROVICË, SKENDERAJ, VUSHTRI, DRENAS

Mbledhjet e mbajtura

Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Dranas gjatë periudhës janar-qershor 2011 kanë funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Gjatë periudhës raportuese, kuvendet e këtyre komunave kanë mbajtur gjithsej 23 mbledhje. Në vijim numri i mbledhjeve është paraqitur në formë grafike:




Fig. 37. Numri i mbledhjeve të mbajtura në Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Dranas

Nga figura e paraqitur del që Komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrria kanë mbajtur nga 6 mbledhje, ndërkohë që komuna e Drenasit ka mbajtur 5 mbledhje.

Në bazë të kësaj, rrjedh konstatimi se komunat në fjalë kanë qenë brenda dinamikës së paraparë me ligj për mbajtje të mbledhjeve.

Në krahasim me periudhën e njëjtë janar-qershor 2010, në periudhën e njëjtë të vitit 2011, aktiviteti i mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve është pothuajse i njëjtë.




Fig. 38. Krahasimi i mbledhjeve të mbajtura të Kuvendeve të Komunave gjatë periudhës janar-qershor 2010 me atë të vitit 2011




Fig. 40. Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri, Drenas

Këto komuna gjatë kësaj periudhe kanë miratuar gjithsej 78 vendime dhe 6 rregullore.

Nga figura vërejmë që Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar 21 vendime dhe 1 rregullore, Kuvendi i Komunës së Skenderajt ka miratuar 9 vendime dhe 4 rregullore, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka miratuar 31 vendime dhe 1 rregullore, ndërsa Kuvendi i Komunës së Drenasit ka miratuar 17 vendime.

Sa i përket njoftimit të mbledhjeve, ftesat dhe materialet nga këto komuna janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së, me përjashtim të Komunës së Drenasit që deri më tani

nuk ka dërguar me kohë ftesën dhe materialin për mbledhje të Kuvendit.

Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur raste të bojkotimit të mbledhjeve nga subjektet politike të përfaqësuara në kuvend. Mbledhjet e Kuvendit gjithmonë kanë qenë të hapura për publikun. Zakonisht në takime është vërejtur prezenca e OSBE-së, ICO të cilët monitorojnë punën e Kuvendeve të Komunave. Poashtu në mbledhje kanë marrë pjesë edhe OJQ-të e ndryshme, mjetet e informimit si dhe e qytetarët. Informimi i qytetarëve për mbledhje apo aktivitetet e komunës është bërë përmes shpalljeve publike dhe ueb faqes së komunës.

Komitetet obligative si trupa të Kuvendit, gjatë kësaj periudhe kanë qenë funksionale. Sipas pasqyrit të mësipërm, në Komunën e Mitrovicës KPF ka mbajtur 6 mbledhje kurse K.K ka mbajtur 5 mbledhje, në Skenderaj dhe Drenas KPF dhe KK kanë mbajtur nga 5 mbledhje, ndërsa në Komunën e Vushtrrisë KPF dhe K.K kanë mbajtur nga 6 mbledhje.

Duhet shtuar që në Komunën e Mitrovicës,





Fig. 39. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të obligueshme në Komuna: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri, Drenas

Drenasi dhe Skenderajt mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete nuk kanë qenë të hapura për publikun. Me këtë rast, Divizioni i Monitorimit konstaton se kemi të bëjmë me shkelje të legjislacionit në fuqi lidhur me transparencën e organeve komunale.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi - KKSBB në Komunitet: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Drenas gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft aktive. Numri i mbledhjeve të KKSBB-së në këto komunale është si në vijim:



Sipas grafikut të mësipërm, në Komunitetin e Mitrovicës gjatë kësaj periudhe KKSBB ka mbajtur 5 mbledhje, në Skenderaj ka mbajtur 5 mbledhje, Vushtrri ka mbajtur 6 mbledhje, ndërkohë që në Drenas ka mbajtur 4 mbledhje.

Përmbledhje nga mbledhjet e Kuvendit

MITROVICA

Kuvendi i Komunitetit të Mitrovicës, gjatë kësaj periudhe janar- qershor 2011 ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunitetit të Mitrovicës ka miratuar raportin financiar për vitin 2010. Lidhur me këtë çështje, janë zhvilluar diskutime të shumta para miratimit, me ç'rast opozita ka qenë mjaft kërkuese në arsyetimin e ç' do shpenzimi që është bërë nga Komuna. Pozita të dyfishta gjatë kësaj periudhe në Komunitetin e Mitrovicës janë evidentuar dy raste ku dy anëtar të kuvendit njëkohësisht punojnë edhe shërbyes civil në administratën e komunës. Ndërkohë që me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit në mbajtjen e pozitave të dyfishta, njëri nga anëtarët e kuvendit ka ofruar dorëheqjen duke zgjedhur pozitën e anëtarit të bordit të një ndërmarrjeje publike.

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në periudhën janar- qershor 2011 ka miratuar 21 vendime dhe 1 rregullore. Në mesin e shumë vendimeve të miratuara me rëndësi, mund të përmendim Vendimin për Emblemën e Komunës që është miratuar në mbledhjen e 31.03.2011, si dhe Vendimin për ndryshimin e statutit të komunës. Po ashtu është miratuar Rregullorja për llogaritjen dhe pagesën e tarifave për rregullimin e tokës ndërtimore.

Një vëmendje i është kushtuar edhe miratimit të disa raporteve të ndërmarrjeve publike, si dhe miratimit të Statuteve të ndryshme, si atë të Teatrit të Qytetit, të Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe Arkivit të Komunës.

Sa i përket ligjshmërisë së akteve, gjatë kësaj periudhe në bazë të monitorimit të mbledhjeve, është evidentuar një rast i shkeljes së ligjit.

Të gjeturat

- Gjatë kësaj periudhe punimet në Kuvend nuk kanë kaluar pa shkelje ligjore. Në mbledhjen e datës 30.06.2011 është vërejtur shkelje procedurave të votimit gjatë miratimit të Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me destinim shtëpi banimi ", duke shkelur kështu Rregulloren e Punës së Kuvendit. Përveç kësaj, ky vendim është në kundërshtim poashtu me Ligjin për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 03/L-226, sepse me vendimin në fjalë prona komunale jepet në shfrytëzim në kohëzgjatje të pacaktuar. Ky vendim është në shqyrtim e sipër nga Departamenti Ligjor i MAPL-së.
- Në Komunën e Mitrovicës, mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete nuk janë të hapura për publikun.
- Edhe pse sipas nenit 80 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i komunës, obligohet që t'ia dërgon organit mbikëqyrës aktet e miratuar për vlerësim të ligjshmërisë, kjo komunë deri më tani nuk ka përmbyshur këtë obligim ligjor.

SKENDERAJ

Kuvendi i Komunës së Skenderajt, gjatë kësaj periudhe ka qenë funksional dhe ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje debatet kanë qenë konstruktive ku mund të konstatojmë se është respektuar Rregullorja e punës së kuvendit.

Deri më tani në Komunën e Skenderajt nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit në vendimmarrje, si dhe nuk është paraqitur ndonjë rast i pozitive të dyfishta të anëtarëve të kuvendit të Komunës së Skenderajt. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi ka miratuar gjithsej 9 vendime dhe 4 rregullore. Ndër aktet më të rëndësishme mund të përmendim miratimin e Vendimi për aprovimin e Planin rregullativ të qytetit të Skenderajt dhe Bashkësisë Lokale në Runik, miratimin e Rregullores për përdorim të

automjeteve zyrtare dhe miratimin e Rregullores për transparencë në Komunë. Po ashtu, gjatë këtij gjashtëmujori, Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e shpenzimeve për vitin 2010, në të cilin janë paraqitur në mënyrë të qartë të gjitha

shpenzimet e komunës.

Komuna e Skenderajt, bënë pjesë në grupin e komunave të cilat respektojnë nenin 80 të LVL-së sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë. Të gjitha aktet e miratuara komuna i dërgon organit mbikëqyrës për vlerësim të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me LVL.

Edhe komitetet e përhershme, për këtë periudhë kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur mbledhjet e parapara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Të gjeturat

- Deri më tani është evidentuar vetëm një shkelje ligjore në marrjen e vendimit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt. Vendim ky që është në kundërshtim me ligjin mbi arsimin fillorë e të mesëm. Vendimi për pezullim nga procesi mësimor i Jetlira Gashit nga Skenderaj, nxënëse e kl. XI/8, për shkak të 32 mungesave të pa arsyeshme dhe 12 me arsye dhe sjellje të pahijshme me personelin mësimor në ShMT "Anton Çetta" në Skenderaj.
- Mbledhjet e KPF-së në këtë komunë nuk kanë qenë të hapura për publikun.

VUSHTRRIA

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme.

Deri tani Divizioni i Monitorimit nuk ka evidentuar raste të konfliktit të interesit me rastin e vendimmarrjes edhe pse raste të pozitive të dyfishta, të cilat konsiderohen si konflikte të interesit nuk janë paraqitur gjatë kësaj periudhe.

Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe janar-qershor 2011, ka miratuar 11 vendime dhe 1 rregullore.

Ndër vendimet me rëndësi më të madhe është ai për caktimin e lokacionit zonë ekonomike për ndërtimin e parkut të biznesit për Komunën e Vushtrrisë, Vendimi për Planin Rregullues Urban (Zona I, II dhe III). Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar edhe kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2012-2014. Sa i përket Rregulloreve është miratuar Rregullorja për shërbimin me merimangë për territorin e Komunës së Vushtrrisë, e që është vlerësuar si e domosdoshme për komunën. Po ashtu është miratuar edhe Rregullorja për caktimin e kriteve për ndarjen e shpërblimeve, dekoratave, çmimeve e mirënjohjeve në Komunën e Vushtrrisë.

Kjo komunë sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve, aktet i dërgon me rregull në organin mbikëqyrës.

Të gjeturat

- Gjatë kësaj periudhe është evidentuar vetëm një rast i shkeljes ligjore.

DRENAS

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe asnjë jashtëzakonshme.

Ajo çfarë është vërejtur në punimet e Kuvendit ka të bëjë me miratimin e vendimeve. Të gjitha vendimet miratohen dhe kalojnë pa ndonjë problem, si rezultat i asaj që në këtë komunë nuk ka nevojë për arritje të konsensusëve politike, ngase partia në qeverisje ka mbi 2/3 e votave në kuvend. Gjithashtu, konflikti i interesit tek anëtarët e kuvendit me rastin e vendimmarrjes nuk është paraqitur. Kuvendi, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 21 vendime dhe 2 rregullore. Ndër vendimet më të rëndësishme ka qenë vendimi për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për periudhën 2011-2014. Komuna e Drenasit deri fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011 nuk ka qenë e rregullt në dërgimin e akteve për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Mirëpo, në bazë të vlerësimit të Divizionit të Monitorimit, deri më tani nuk është evidentuar ndonjë shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve

Të gjeturat

- Mbledhjet e KPF-së në Komunën e Drenasit nuk kanë qenë të hapura për publikun.
- Në komunën e Drenasit, anëtari i Kuvendit I. G. është njëherësh edhe pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Lidhur me këtë MAPL ka dhënë përgjigjen në shkresë drejtuar Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Drenasit. Me këtë rast MAPL ka konstatuar se kemi të bëjmë me mbajtje të pozitave të dyfishta. Të jeshë anëtar i ndonjë subjekti politik dhe njëkohësisht pjesëtar i Forcës së Sigurisë të Kosovës bie ndesh me nenin 11 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr. 03/L-046, i cili ka përcaktuar se Forca e Sigurisë së Kosovës nuk mund të përdoret për qëllime politike apo për veprimtari politike. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë nuk mund të jenë anëtarë të partive politike e as nuk mund të shfaqin haptazi shenja të përkrahjes së cilësdo parti politike.

● Konkluzione

1 Komuna e Mitrovicës dhe Drenasit nuk i dërgojnë aktet për vlerësim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës konform LVL neni 80.1.

2 Në Komunën e Mitrovicës, Skenderajt dhe të Drenasit, mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë qenë të hapura për publikun.

3 Në Komunën e Mitrovicës, ende vazhdojnë të mbajnë pozita të dyfishta

nga dy anëtarë të kuvendit!

4 Komuna e Vushtrisë ka miratuar Planin Zhvillimor Urban.

5 Komuna e Skenderajt ka miratuar Rregullores për transparencë.

6 Komuna e Mitrovicës e ka ndryshuar Statutin e komunës, me ç'rast ka harmonizuar numrin e drejtorive me statut.

7 Nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit në vendimmarrje.

REKOMANDIMET E PËRGJITHËSHME

Në bazë të të gjeturave në raport, Divizioni i monitorimit ka vënë në theks disa rekomandime për komunat, të paraqitura si në vijim:

- Komunat të dërgojnë me rregull aktet e miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës.
- Komunat t'i rishqyrtojnë të gjitha vendimet që MAPL i vlerëson se nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Komunat t'i dërgojnë me kohë ftesën dhe materialet e mbledhjeve të kuvendit në MAPL.
- Komuna e Graçanicës të emëroj nënkryetarin e Komunës për Komunitete.
- Komuna e Graçanicës të siguroj përkthimin e të gjitha akteve të miratuara në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Të krijohet praktikë për kryesuesit e Kuvendeve të Komunave që para votimit të çështjeve në kuvend, të pyesin kuvendarët për konfliktin eventual të interesit.
- Komunën e Prishtinës, Mitrovicës, Skenderajt dhe Glllogovcit të jenë të hapura në takimet e Komiteteve obligative, konform legjislacionit në fuqi.
- Komunat në të cilat janë evidentuar pozita të dyfishta, të zbatojnë Udhëzimin Administrativ nr.01/2010 MAP-nr.01/2010 MAPL, për kufizimet e kompenzimit dhe marrjes së pagës nga zyrtarët e komunave të cilët mbajnë pozita të dyfishta.
- Komunat të rrisin dinamikën e mbajtjes së takimeve të KKSBB-ve.
- Komuna e Vitisë të respektoj nenin 54 të LVL-së lidhur me pozitën e zëvendëskryesuesit të Kuvendit për Komunitete.
- Komunat të respektojnë procedurat me rastin e nxjerrjes së akteve në kuvend, konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
- Komunat të harmonizojnë numrin e drejtorive konform Statutit.
- Komuna e Lipjanit të shuaj pozitën e njërit nënkryetar të Komunës.
- Komuna e Ranillugut të respektoj nenin 5.5. të Ligjit për Kufijtë Administrativ Nr. 03/L-041 me të cilin parashihet që selia e Komunës së Ranillugut të jetë në Ranillug.

EFIKASITETI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNAVE

Në vazhdim të Raportit të paraqesim të dhënat mbi numrin e përgjithshëm të kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve administrative të komunave nga periudha janar-qershor 2010. Të dhënat tabelore japin pasqyrë të qartë për të gjitha kërkesat e shqyrtuara, pushqyrtuara, refuzuara, pezulluara si dhe atyre të cilat janë në pritje.

Për saktësinë e të dhënave, janë përgjegjëse Komunitet e Republikës së Kosovës.

GJAKOVË

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Gjakovës për gjashtëmujorin e parë 2011 është 7046 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë gjithsej 6489 kërkesa marrë në përqindje 92.09%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 10224, në këtë vit numri i kërkesave ka qenë më i vogël. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 9022 kërkesa. Megjithatë numri i kërkesave në vitin 2010 ka qenë më i madh ku kërkesa të shqyrtuara kanë qenë 88.24 %, në vitin 2011 përqindja e shqyrtimit të kërkesave ka një ngritje dhe është 92.09%.

Për gjashtëmujorin e parë 2011, Komuna e Gjakovës ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

Drejtorja e Administratës dhe Personelit – ka pasur gjithsej 663 kërkesa, janë shqyrtuar 611 kërkesa, ndërsa 52 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – ka pranuar 491 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtorja e Arsimit - ka pasur 252 kërkesa, të shqyrtuara janë 196, ndërsa 56 kërkesa ende nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – ka pasur 62 kërkesa, prej tyre janë shqyrtuar 38 kërkesa, ndërsa nuk janë shqyrtuar ende 24 kërkesa.

Drejtorja për Financa – ka pasur 138 kërkesa, që të gjitha janë të shqyrtuara.

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik – ka pasur 800 kërkesa, të shqyrtuara janë 760 kërkesa, ndërsa 40 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – ka pasur 114 kërkesa, janë shqyrtuar 55 kërkesa, ndërsa 59 kërkesa nuk janë shqyrtuar.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – ka pasur 28 kërkesa, janë shqyrtuar 7, ndërsa 21 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – ka pasur 3622 kërkesa, të gjitha kërkesat janë shqyrtuar.

Drejtoria për Shërbime Publike – ka pasur 122 kërkesa, të shqyrtuara janë 118 kërkesa, ndërsa 4 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim – ka pasur 107 kërkesa, janë shqyrtuar 102, ndërsa 5 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Punë Inspektuese – ka pasur 647 kërkesa, janë shqyrtuar 351 kërkesa, ndërsa 296 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

DEÇAN

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Deçanit për gjashtëmujorin e parë 2011 është 2307 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 2151 kërkesa, ose 93.23%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 959, në këtë vit numri i kërkesave ka pasur ngritje dhe në përgjithësi kemi 2307 kërkesa. Sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 897 kërkesa. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 93.53 % në vitin 2011 përqindja në shqyrtimin e kërkesave ka mbetur po thuaj se e përafërt dhe atë 92.09%.

Për gjashtëmujorin e parë të 2011, Komuna e Deçanit ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

Drejtoria për Administratë dhe Personel – ka pasur gjithsej 467 kërkesa, të shqyrtuara janë 456 kërkesa, ndërsa 11 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa – ka pasur gjithsej 69 kërkesa, janë shqyrtuar gjithsej 58 kërkesa, ndërsa 11 kërkesa mbeten ende të pashqyrtuara.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – ka pasur gjithsej 53 kërkesa, janë shqyrtuar 51 kërkesa, ndërsa 2 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria e Arsimit – ka pasur gjithsej 194 kërkesa, janë shqyrtuar 150 kërkesa, ndërsa 44 kërkesa ende nuk janë shqyrtuar.

Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit – ka pasur gjithsej 190 kërkesa, 149 janë shqyrtuar, ndërsa 41 ende nuk janë shqyrtuar.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – ka pasur gjithsej 82 kërkesa, të shqyrtuara janë 69 kërkesa ndërsa 13 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike – Ka pasur 124 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim – ka pasur 50 kërkesa, të shqyrtuara janë 48 kërkesa, ndërsa 2 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Inspektion – ka pasur 99 kërkesa dhe të gjitha janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport – ka pasur 69 kërkesa, janë shqyrtuara 61 kërkesa ndërsa 8 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – ka pasur 910 kërkesa, 886 kërkesa janë shqyrtuar, ndërsa 24 kërkesa ende nuk janë shqyrtuar.

RAHOVEC

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Rahovecit për gjashtëmujorin e parë 2011 është 8719 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë 8540 kërkesa ose 97.94%,

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 10245, në këtë vit numri i kërkesave ka pasur rënie dhe në përgjithësi kemi 8719 kërkesa. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 9895 kërkesa. Nga kjo konstatojmë se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 96.58 % në vitin 2011 përqindja në shqyrtimin e kërkesave ka mbetur po thuajse e njëjtë më një ngritje të lehtë në 97.94%.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

Drejtoria e Administratës dhe Personelit - ka pasur gjithsej 5287 kërkesa, të shqyrtuara 5286 kërkesa, ndërsa një kërkesë nuk është shqyrtuar ende.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka pasur gjithsej 162 kërkesa, të shqyrtuara janë 78 kërkesa, ndërsa 84 kërkesa mbeten të pashqyrtuara.

Drejtoria për Financa, Buxhet - ka pasur gjithsej 766 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 17 kërkesa, të shqyrtuara 15 kërkesa, ndërsa 2 kërkesa kanë mbetur të pashqyrtuara.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – ka pasur gjithsej 115 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtoria për Punë Inspektuese - ka pasur gjithsej 215 kërkesa, të shqyrtuara janë gjithsej 204 kërkesa, ndërsa 9 kërkesa kanë mbetur të pashqyrtuara..

Drejtoria e Arsimit – ka pasur gjithsej 9 kërkesa, të gjitha kërkesat janë shqyrtuar.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ekonomi dhe Zhvillim - ka pasur gjithsej 276 kërkesa, që të gjitha janë të shqyrtuar.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - ka pasur gjithsej 1466 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë - ka pasur gjithsej 203 kërkesa, të shqyrtuara janë 120, ndërsa nuk janë shqyrtuar ende 83 kërkesa.

Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim - ka pasur gjithsej 203 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

JUNIK

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Junikut për gjashtëmujorin e parë 2011 është 2525 kërkesa. Prej tyre, të shqyrtuara janë 2461 ose marrë në përqindje 97.46%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 274, në këtë vit numri i kërkesave ka pasur ngritje dhe në përgjithësi kemi 2525 kërkesa. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 263 kërkesa. Nga kjo konstatojmë se derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 95.98%, në vitin 2011 përqindja në shqyrtimin e kërkesave ka pasur ngritje në 97.46%.

Për gjashtëmujorin e parë 2011, Komuna e Junikut ka ofruar të dhënat për këto drejtori:

Drejtorja e Administratës – ka pasur gjithsej 2147 kërkesa, të shqyrtuara janë 2128 kërkesa, ndërsa 19 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Buxhet dhe Financa - ka pasur gjithsej 28 kërkesa, të shqyrtuara janë 27 kërkesa, ndërsa 1 kërkesë nuk është shqyrtuar ende.

Drejtorja për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport - ka pasur gjithsej 10 kërkesa, të shqyrtuara janë gjithsej 7, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – ka pasur 5 kërkesa, është shqyrtuar vetëm 1 kërkesë, ndërsa 4 kërkesa nuk janë shqyrtuar.

Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis - ka pasur 290, të shqyrtuara janë 271 kërkesa, ndërsa 19 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim – ka pasur 30 kërkesa, 22 janë shqyrtuar, ndërsa 8 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Ekonomi dhe Zhvillim – ka pasur 15 kërkesa, të shqyrtuara janë 5 kërkesa, ndërsa 10 kërkesa nuk janë shqyrtuar.

GJILAN

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Gjilanit për periudhën janar-qershor 2011 është 6714 kërkesa, të shqyrtuara janë 4997 kërkesa ose 74 %.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 6832, në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është zvogëluar për 118 kërkesa më pak. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në periudhën janar-qershor 2010 janë shqyrtuar 5092 ose 74.5%. Nga kjo konstatojmë se, derisa në periudhën janar-qershor 2010 janë

shqyrtuar 74.5% të kërkesave, në periudhën janar-qershor 2011 kjo përqindje është 74%.

Komuna e Gjilanit ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme- ka pasur gjithsej 1261 kërkesa, të shqyrtuara 1082 kërkesa.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale- ka pasur gjithsej 515 kërkesa, të shqyrtuara 382 kërkesa.

Drejtoria për Arsim- ka pasur gjithsej 166 kërkesa, të shqyrtuara 2 kërkesa.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim- ka pasur gjithsej 648 kërkesa, të shqyrtuara 551 kërkesa.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- ka pasur gjithsej 367 kërkesa, të shqyrtuara 188 kërkesa.

Drejtoria për Inspektion- ka pasur gjithsej 398 kërkesa, të shqyrtuara 243 kërkesa.

Drejtoria për Shërbime Publike- ka pasur gjithsej 441 kërkesa, të shqyrtuara 423 kërkesa.

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari- ka pasur gjithsej 535 kërkesa, të shqyrtuara 121 kërkesa.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – ka pasur gjithsej 128 kërkesa, të shqyrtuara 78 kërkesa.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim – ka pasur gjithsej 2233 kërkesa, të shqyrtuara 4825 kërkesa.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim- ka pasur gjithsej 62 kërkesa, të shqyrtuara 1917 kërkesa.

KAMENICË

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Kamenicës për periudhën janar-qershor 2011 është 13194 kërkesa, të shqyrtuara janë 13129 kërkesa ose 99 %.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 8196 (raporti është vetëm për 10 drejtori), në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është rritur për 4998 kërkesa më shumë. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në periudhën janar-qershor 2010 janë shqyrtuar 7977 ose 97.32%. Nga kjo konstatohet se, derisa në periudhën janar-qershor 2010 janë shqyrtuar 97.32% të kërkesave, në periudhën janar-qershor 2011 kjo përqindje është 99%.

Komuna e Kamenicës ka ofruar të dhëna për këto drejtori :

Drejtoria e Administratës dhe Personelit- ka pasur gjithsej 10780 kërkesa, të shqyrtuara 10780 kërkesa.

Drejtoria e Arsimit- ka pasur gjithsej 46 kërkesa, të shqyrtuara 46 kërkesa.

Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa- ka pasur gjithsej 45 kërkesa, të shqyrtuara 45 kërkesa.

Drejtoria për Inspektion- ka pasur gjithsej 171 kërkesa, të shqyrtuara 171 kërkesa.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor – ka pasur gjithsej 92 kërkesa, të shqyrtuara 83 kërkesa.

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi- ka pasur gjithsej 424 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej

383 kërkesa.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – ka pasur gjithsej 1110 kërkesa, të shqyrtuara 1110 kërkesa.

Drejtoria për Shërbime Publike– ka pasur gjithsej 53 kërkesa, të shqyrtuara 40 kërkesa.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport– ka pasur gjithsej 36 kërkesa, të shqyrtuara 36 kërkesa.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim– ka pasur gjithsej 12 kërkesa, të shqyrtuara 10 kërkesa.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural– ka pasur gjithsej 425 kërkesa, të shqyrtuara 425 kërkesa.

NOVOBËRDË

Efikasiteti i organeve të administratës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Novobërdës për periudhën janar-qershor 2011 është 605 kërkesa, të shqyrtuara janë 602 kërkesa ose 99.5%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 280(raporti është vetëm për 6 drejtori), në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është rritur për 325 kërkesa më shumë. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në periudhën janar-qershor 2010, janë shqyrtuar 280 ose 100%. Nga kjo konstatohet se, derisa në periudhën janar-qershor 2010 janë shqyrtuar 100% të kërkesave, në periudhën janar-qershor 2011 kjo përqindje është 95.5%.

Komuna e Novobërdës ka ofruar të dhëna për këto drejtori :

Drejtoria e Administratës dhe Personelit– ka pasur gjithsej 62 kërkesa, të shqyrtuara 62 kërkesa.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale – ka pasur gjithsej 48 kërkesa, të shqyrtuara 48 kërkesa.

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë – ka pasur gjithsej 23 kërkesa, të shqyrtuara 23 kërkesa.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim– ka pasur gjithsej 19 kërkesa, të shqyrtuara 19 kërkesa.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Pronë – ka pasur gjithsej 18 kërkesa, të shqyrtuara 18 kërkesa.

Drejtoria për Urbanizëm ,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit– ka pasur gjithsej 193 kërkesa, të shqyrtuara 193 kërkesa.

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim– ka pasur gjithsej 8 kërkesa, të shqyrtuara 8 kërkesa.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural– ka pasur gjithsej 186 kërkesa, të shqyrtuara 186 kërkesa.

Drejtoria për Komunitete dhe Kthim– ka pasur gjithsej 28 kërkesa, të shqyrtuara 186 kërkesa.

Drejtoria për Inspektion– ka pasur gjithsej 20 kërkesa, të shqyrtuara 17 kërkesa.

RANILLUG***Efikasiteti i organeve të administratës***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Ranillugut për periudhën janar-qershor 2011 është 541, të shqyrtuara janë 541 ose marrë në përqindje është 100%.

Komuna e Ranillugut ka ofruar të dhëna për këto drejtori :

Drejtoria e Administratës dhe Personelit- ka pasur gjithsej 25 kërkesa, të shqyrtuara 25 kërkesa.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa - ka pasur gjithsej 25 kërkesa, të shqyrtuara 25 kërkesa.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka pasur gjithsej 18 kërkesa, të shqyrtuara 18 kërkesa.

Drejtoria e Arsimit- ka pasur gjithsej 4 kërkesa, të shqyrtuara 4 kërkesa.

Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka pasur gjithsej 24 kërkesa, të shqyrtuara 24 kërkesa.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural- ka pasur gjithsej 56 kërkesa, të shqyrtuara 56 kërkesa.

Drejtoria për Inspektion - ka pasur gjithsej 7 kërkesa, të shqyrtuara 7 kërkesa.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport- ka pasur gjithsej 16 kërkesa, të shqyrtuara 16 kërkesa.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - ka pasur gjithsej 366 kërkesa, të shqyrtuara 366 kërkesa.

FERIZAJ***Efikasiteti i organeve administrative***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Ferizajt për periudhën janar-qershor 2011 është 6249, të shqyrtuara janë 5708 kërkesa ose 91,34 %.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 12229, në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është zvogëluar për 5980 kërkesa më pak. Kurse, sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në periudhën janar-qershor 2010, janë shqyrtuar 11717 ose 95.81%. Nga kjo konstatohet se, derisa në periudhën janar-qershor 2010 janë shqyrtuar 95.81%, në periudhën janar-qershor 2011 kjo përqindje është 91.34%.

Komuna e Ferizajt ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 1694, të shqyrtuara janë 1627 kërkesa, ndërsa 67 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - Në këtë

drejtori janë pranuar 2342 kërkesa, të shqyrtuara janë 2025 kërkesa, ndërsa 317 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Arsim - Në këtë drejtori janë pranuar 419 kërkesa, të shqyrtuara janë 412 kërkesa, ndërsa të pa shqyrtuara janë 7.

Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet - Në këtë drejtori janë pranuar 487 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 412 kërkesa, ndërsa 75 ende nuk janë të shqyrtuara.

Drejtorja për Planifikim dhe Zhvillim - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 88 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 77 kërkesa, ndërsa 11 ende nuk janë shqyrtuar.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Në këtë drejtori janë pranuar 218 kërkesa, të shqyrtuara janë 200, ndërsa 18 nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 17 kërkesa dhe që të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 129 kërkesa, të shqyrtuara janë 109 kërkesa, ndërsa 20 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 231 kërkesa, të shqyrtuara janë 214 kërkesa, ndërsa të pa shqyrtuara janë 17.

Drejtorja e Inspektionit - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 601 kërkesa, të shqyrtuara janë 592 kërkesa, ndërsa 9 kërkesa mbeten ende të pa shqyrtuara.

Zyra komunale e komuniteteve: ka pasur gjithsej 23 kërkesa, ku të gjitha janë shqyrtuar.

KAÇANIKU

Efikasiteti i organeve administrative

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Kaçanikut për periudhën janar-qershor 2011 është 5826, të shqyrtuara janë 5459 ose 93.70%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 4810, në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është rritur për 1016 kërkesa më shumë. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2011 janë shqyrtuar 5459 kërkesa. Nga kjo konstatohet se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 97.46 % në vitin 2011 kjo përqindje ka rënë në 93.70%.

Komuna e Kaçanikut ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

Drejtorja për Administratë së përgjithshme – Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 2539 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

Drejtorja Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 882 kërkesa, të shqyrtuara janë 804 kërkesa, ndërsa 78 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 1713 kërkesa, të shqyrtuara janë 1691, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 22 kërkesa.

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - Në këtë drejtori janë pranuar 168 kërkesa, të shqyrtuara janë 94, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 74 kërkesa.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Në këtë drejtori janë pranuar 63 kërkesa, të shqyrtuara janë 59, ndërsa të pa shqyrtuara janë 4.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Në këtë drejtori janë pranuar 277 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 166 kërkesa, ndërsa 111 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtoria e Shërbime Publike dhe emergjencë civile - Në këtë drejtori janë pranuar 184 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara 106, ndërsa 78 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

SHTIME

Efikasiteti i administratës së komunës

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Shtimes për periudhën janar-qershor 2011 është 1100, të shqyrtuara janë 1029 ose 93,54%.

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 4264, në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është shumë më i vogël dhe atë 1100 kërkesa. Sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 4252 ose 99.71%. Ndërkohë që në vitin 2011 është përqindje më e vogël e kërkesave të shqyrtuara në gjithsej 93.54%.

Komuna e Shtimes ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

Drejtoria për Administratë dhe Personel – Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 516, të shqyrtuara janë 515, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 1 kërkesa.

Drejtoria për Planifikim urban kadastër dhe gjeodezi - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 418 kërkesa, të shqyrtuara 390, ndërsa të pashqyrtuara janë 28 kërkesa.

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 60 kërkesa, të shqyrtuara janë 55 kërkesa, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 5 kërkesa.

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Rini dhe Sport - Në këtë drejtori janë pranuar 27 kërkesa, të miratuara 5 ndërsa 22 ende nuk janë shqyrtuar.

Drejtoria për Shërbime Publike - Në këtë drejtori ka pasur gjithsej 29 kërkesa, të shqyrtuara janë 28, ndërsa ende nuk është shqyrtuar 1 kërkesë.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Në këtë drejtori janë pranuar gjithsej 48 kërkesa, të shqyrtuara janë 34 kërkesa, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 14 kërkesa.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - Në këtë drejtori janë pranuar 2 kërkesa dhe janë shqyrtuar.

SHTËRPECË***Efikasiteti i organeve të administratës***

Numri i përgjithshëm i kërkesave të qytetarëve të paraqitura para organeve të administratës së Komunës së Shtërpcës për periudhën janar-qershor 2011 është 678, të shqyrtuara janë 572 ose 84,36 % .

Nga kjo vërehet se krahasuar me periudhën janar-qershor 2010, ku numri i kërkesave të përgjithshme ishte 367, në periudhën janar-qershor 2011 numri i kërkesave është rritur për 678 kërkesa më shumë. Kurse sa u përket kërkesave të shqyrtuara, në vitin 2010 janë shqyrtuar 311. Nga kjo konstatohet se, derisa në vitin 2010 janë shqyrtuar 84.74 % në vitin 2011 kjo përqindje ka mbetur përafërsisht e njëjtë në 84.36%.

Komuna e Shtërpcës ka ofruar të dhëna për këto drejtori:

Drejtorja për Administratë dhe Personel – Në këtë drejtori janë pranuar 86 kërkesa, të shqyrtuara janë 81, ndërsa 5 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

Drejtorja për Buxhet dhe Financa - Në këtë drejtori janë pranuar 268 kërkesa, të shqyrtuara janë 257, ndërsa 11 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

